

Doracak për mësimin e
Holokaustit



SHKOLLA E MËSIMËNËSVE TE HISTORIS SE KOSOVES
HISTORY TEACHERS ASSOCIATION OF KOSOVA



forumZFD



Doracak për mësimin e
Holokaustit

DORACAK PËR MËSIMIN E HOLOKAUSTIT

Autorë:

Saniqe Berisha, Blerim Carani, Fetnan Derviş, Joanna Hanson, Igor Kakolewski, Besim Kuqi, Vincent Lungwitz, Gazmend Mirena, Afërdita Misimi, Valentina Pancaldi, Dominik Pick, Enver Sadiku, Arbër Salihu, Dren Terziqi, Afrim Topçideri, Nazlije Topçideri, Gjon Tushaj, Donika Xhemajli, Napulon Zeqiri

Redaktorë:

Joanna Hanson, Igor Kakolewski, Vincent Lungwitz, Valentina Pancaldi, Dominik Pick, Arbër Salihu, Donika Xhemajli

Përkthyes:

Abdullah Ferizi, Ivana Radoviq

Faqosja dhe botimi:

Envinion

Prishtinë, nëntor 2020

Idetë e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Kosovës.

Tabela e përmbajtjes

06	Parathënie
09	Njësia mësimore 1: Historia e Antisemitizmit
10	Pjesa rrëfyese/përshkruese
15	Ushtrimet për nxënësit
18	Shtojcat
21	Njësia mësimore 2: Holokausti
22	Pjesa rrëfyese/përshkruese
28	Ushtrimet për nxënësit
33	Shtojcat
39	Njësia mësimore 3: Kosova dhe Holokausti
40	Pjesa rrëfyese/përshkruese
47	Ushtrimet për nxënësit
52	Shtojcat
54	Fjalori

Parathënie

Pse ky publikim?

Qëllimi i këtij publikimi dedikuar Holokaustit dhe mësimdhënies për të në Kosovë është që të shtojë kapacitetet e mësimdhënësve kosovarë dhe të nxisë përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në zhvillimin e materialeve dhe teksteve mësimore. Shpresohet se botuesit dhe institucionet arsimore do ta pranojnë dhe ndjekin këtë strukturë.

Njësitë mësimore të përfshira në këtë botim janë zhvilluar me qëllimet si në vijim:

- 1 Të promovojë shumëperspektivitetin (multiperspektivitetin, kendveshtrime te ndryshme) në mësimin e historisë në mënyrë që nxënësit të mësojnë bashkëndjenjën (empatinë) me/dhe kuptimin e pikëvështrimeve të të tjerëve;
- 2 Të paraqesë burimet parësore (primare) dhe dytësore (sekondare) në mënyrë që nxënësit të mësojnë si t'i vlerësojnë dhe t'i interpretojnë ato. Këto janë aftësi shumë të rëndësishme për të menduarit e tyre kritik shqyrtues, që është posaçërisht i rëndësishëm në kohën e "lajmeve të rreme";
- 3 Të përfshijë imazhet dhe grafikët si mjete mësimore;
- 4 Të paraqesë ushtrimet ndërvepruese (interaktive) për të nxitur mësimin veprues, të menduarit kritik dhe punën ekipore.

Në këtë mënyrë, këto njësi mësimore demonstrojnë se si mund të arrihet kalimi prej mësimi të bazuar në njohuri në mësimin e bazuar në aftësi, siç është paraparë në kornizën kurrikulare.

Si rezultat, mësimi i historisë është konceptuar si mjet bazik gjithashtu për kuptimin e të tashmes. Të mësuarit kritik lidhur me të kaluarën dhe të kuptuarit e saj ju mundëson nxënësve ta shqyrtojnë, të parashatrojnë pyetjet dhe ta kuptojnë realitetin e tashëm.

Për kë është ky publikim?

Ky publikim lidhur me edukimin për Holokaustin është paraparë të përdoret nga mësimdhënësit e historisë në Kosovë si burim plotësues i një cilësie të mirë.

Njësitë mësimore krijojnë një burim për mësimdhënësit e historisë në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Në pajtim me kornizën kurrikulare të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Kosovë (2016), tri njësitë mësimore janë të dedikuara për nxënësit e klasave IX dhe XII, pasi që tema e Holokaustit është e përfshirë në këto faza të procesit arsimor.

Çfarë mund të gjendet në këtë publikim?

Tri njësi mësimore janë të përfshira në këtë publikim; secila prej tyre përbëhet nga pjesa rrëfyese/përshkruese dhe ajo ndërvepruese:

Njësia mësimore 1: Historia e Antisemitizmit

Njësia mësimore 2: Holokausti

Njësia mësimore 3: Kosova dhe Holokausti

Pjesa rrëfyese/përshkruese ju ofron nxënësve informatat e nevojshme për të kuptuar Holokaustin, origjinën, zhvillimin dhe pasojat e tij, me fokus të veçantë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor.

Pjesët ndërvepruese ju ofrojnë mësimdhënësve disa ushtrime për nxënësit, që synojnë nxitjen e të menduarit kritik dhe mësimin aktiv. Këto ushtrime ndërlidhen me përmbajtjen e pjesës rrëfyese/përshkruese. Janë dhënë edhe udhëzimet për mësimdhënësit, koha e kërkuar, si edhe materialet (Shtojcat) e nevojshme për ushtrimet. Bazuar në nivelin e vështirësisë së ushtrimit dhe ndërlikueshmërisë së diskutimeve, detyrat rekomandohen t'ju propozohen vetëm nxënësve të klasave IX, ose XII, ose të dy klasëve.

Krahas njësive mësimore, ka edhe një fjalorth në fund të këtij publikimi.

Si të përdoret ky publikim?

Njësitë mësimore janë menduar të shërbejnë si material plotësues dhe alternativ për tekstet mësimore të historisë që tashmë përdoren. Secila njësi mësimore mund të përdoret për një a më shumë orë mësimore të historisë, varësisht kohës në dispozicion.

Pjesët rrëfyese/përshkruese ju ofrohen nxënësve, të shqyrtohen në klasë ose të jepen si detyrë shtëpie, derisa ushtrimet ndërvepruese përdoren nga mësimitdhënësit si referencë gjatë orës mësimore (dhe nuk i shpërndahet nxënësve). Mësimdhënësit duhet të zgjedhin ushtrimet më të përshtatshme që do të zhvillohen me nxënësit, t'ju ofrojnë shpjegime sipas udhëzimeve të dhëna dhe t'ju shpërndajnë nxënësve Shtojcat, sipas nevojës së tyre. Ushtrimet kryesisht do të bëhen nga nxënësit të ndarë në grupe. Rekomandohet që të planifikohet një kohë për diskutim të shkurtë pas secilit ushtrim, i ndihmuar nga mësimitdhënësi, me qëllim të sqarimit të porosit kryesore dhe qëllimeve të mësimit të asaj njësie mësimore.

Është me rëndësi të kuptohet se metodologjia e propozuar për ushtrimet është e ndryshueshme dhe është menduar si referencë për mësimitdhënësit, të cilët do ta përshtatin ushtrimin sipas aftësive të nxënësve dhe burimeve në dispozicion.

Ani pse të trija njësitë mësimore janë menduar si të tilla që e plotësojnë njëra-tjetrën, vet mësimitdhënësit duhet të vlerësojnë se sa ia vlen të përdoret materiali i propozuar si edhe relevancën e pjesëve të caktuara, bazuar në procesin e tyre mësimor dhe kohën në dispozicion.

Si u zhvillua ky material?

Në vitin 2015, Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Kosovës iu drejtua organizatës forumZFD me kërkesë për bashkëpunim për të përmirësuar edukimin për Holokaustin në Kosovë. Shoqata e Mësimdhënësve të Historisë së Kosovës u përfshi në projekt. Anëtarët e saj morrën pjesë në një trajnim në Yad Vashem (Izrael), dhe një numër i punëtorive u organizuan në vitet që pasuan, në bashkëpunim me Yad Vashem, Qendrën për Hulumtim të Historisë në Akademinë Polake të Shkencave në Berlin, New Perspektiva dhe Haus der Wannseekonferenz në Berlin. Muzeu i Përkujtimit të Holokaustit i Shteteve të Bashkuara gjithashtu ofroi përkrahje për këtë projekt.

Si rezultat, pjesëmarrësit i shtuan njohuritë e tyre lidhur me Holokaustin dhe zhvilluan më tej kapacitetet e tyre rishtarë në shkrimin e teksteve mësimore. Me synimin për të krijuar një material të përshtatshëm për mësimitdhënësit, forma e zakonshme e shkrimit të një kapitulli të tekstit mësimor ka ndryshuar në drejtim të formësimit të njësive mësimore.

Kapitulli 1

Historia e Antisemitizmit

Antisemitizmi është një dukuri e vjetër, që u lajmërua në kohët e lashta dhe u rishfaq në vazhdimësi përgjatë historisë. Kjo dukuri u paraqit në forma dhe mënyra të ndryshme. Fillimisht, përgjatë shumë shekujsh u manifestua kryesisht në fyerjet religjioze të shumicave johebreje ndaj komunitetit hebre. Pas gjysmës së dytë të shekullit XIX, antisemitizmit iu bashkuan edhe rrëfimet raciste dhe ideologjike. Si ndryshoi antisemitizmi religjioz (antijudaizmi) në antisemitizëm racor? Cilat dukuri në Evropë dhe në historinë moderne kontribuan në zhvillimin e tij?



Rrënojat e Sinagogës në Sarandë, shekulli VI i erës së re

Burimi: <https://www.world-archaeology.com/world/europe/albania/synagogue-in-saranda-albania/>

Prejardhja dhe zhvillimi i antijudaizmit

Shenjat e para të urrejtjes ndaj hebrenjve shkojnë prapa deri në kohët e lashta. Ato dalin në sipërfaqe sidomos pas shekullit të VI e. r, kur hebrenjtë, të ndjekur nga vendlindjet e tyre në Lindje të Mesme, u desht të jetonin si pakica në vende jo-hebreje të shpërndarë në hapësirat më të largëta (diaspora). Ndjenja antihebreje u paraqitën në Greqinë dhe Romën e lashtë. Njëjtë, antijudaizmi u paraqit në krishterimin e hershëm, kur u bë e qartë se hebrenjtë nuk do ta pranonin Jezun Krishtin si Mesiah dhe si pasojë u akuzuan për komplot kundër atij që të krishterët e konsideron "Shpëtimtarin e njerëzimit". Prandaj, ndjenja antijudaike mbetën mbizotëruese në shumë komunitete të krishtera përgjatë mesjetës.

Sulmet ndaj hebrenjve vazhduan në Evropë në mes të shekujve XV e XVIII. Ato përfshinin prej keqtrajtimit verbal deri te vrasjet. Akuzimi i rremë se hebrenjtë mbysnin fëmijët e krishterë dhe përdornin gjakun e tyre për rituale filloi të përhapet përgjatë popujve të krishterë, bashkë me akuzën se hebrenjtë përdhosnin kishat e krishtera. Mijëra hebrenj të pafajshëm u arrestuan dhe u torturuan e, në disa raste u ekzekutuan.

Hebrenjtë në rajon

Hebrenjtë e parë u vendosën në tokat ilire pas shkatërrimit të Tempullit në Jerusalem nga romakët, në vitin 70, e.r.. Ardhja e tyre tregohet si legjendë, sipas së cilës një anije me skllavë hebrenj nga Palestina që po lundronte për në Romë u ballafaqua me një shtrëngatë dhe iu desht të ndërroj drejtimin kah brigjet e Ilirisë. Sipas hulumtimeve arkeologjike,

Çka nënkuptojmë me antisemitizëm?

1: Përshkrim i antisemitizmit nga Muzeu i Përkujtimit të Holokaustit në SHBA:

Paragjykimi kundër hebrenjve ose urrejtja ndaj tyre, e njohur si antisemitizëm – e ka shqetësuar botën për më shumë se 2,000 vjet. Holokausti, ndjekja dhe vrasja e sponzorizuar nga një shtet, e hebrenjve evropianë në mes të viteve 1933 e 1945, nga Gjermania nacistë dhe bashkëpunëtorët e saj është shembulli më ekstrem i antisemitizmit. Prapëseprapë, edhe pas pasojave të Holokaustit, antisemitizmi mbetet një kërcënim i vazhdueshëm. Kjo urrejtje paraqitet në literaturë, art, film, fjalime, ligjislacion, e edhe në internet, si edhe manifestohet me akte të dhunës.

Burimi: <https://www.ushmm.org/collections/bibliography/antisemitism> (qasja 25.02.2020)

2. Një historian gjerman lidhur me dallimin në mes të antisemitizmit dhe antijudaizmit, thotë:

Fjala "antisemitizëm" nga njëra anë shërben si shprehje e përgjithshme për çdo lloj armiqësie ndaj hebrenjve. Në anën tjetër, më konkretisht, si shprehje e formësuar në çerekun e fundit të shekullit XIX, ajo tregon një paragjykim të ri anti-hebre, pseudo-shkencor, e cila nuk argumentonte më nga aspekti religjioz, por i përfshiu edhe cilësitë dhe karakteristikat e ndërlidhura me "racën". Duhet bërë dallim në mes të anti-judaizmit të vjetër të motivuar nga religjioni dhe antisemitizmi modern (...). Në gjuhën moderne, përdorimi i shprehjes anti-semitizëm mbulon totalin e deklaratave, trendeve, fyerjeve, qëndrimeve dhe veprimeve anti-hebre, pa marrë parasysh motivimet religjioze, raciste, shoqërore ose të tjera pas tyre. Teoriticienët antisemitikë pajtohen në pohimet e tyre që secila "karakteristikë racore" e hebrenjve ishte negative, dhe cilësia që e dallonte nga antijudaizmi i vjetër ishte besimi që "karakteristikat racore" ishin, si edhe besimet religjioze, të pandryshuara.

Burimi: Wolfgang Benz, anti-semitizmi dhe hulumtimet për anti-semitizmin https://docupedia.de/zg/Benz_antisemitismus_v1_en_2011 (qasja 25.02.2020)

besohet se marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike kanë ekzistuar në kohët e lashta, mes popujve që jetonin në Kosovën e sotme dhe Israelin e sotëm. Gjatë mesjetës, një numër i madh i hebrenjve që u vendosën në Kosovë ishin hebrenjtë e ndjekur nga Spanja. Hebrenjtë në Kosovë kishin profesione të ndryshme si zanatçi të metaleve të çmuara e tregtarë, dhe kryesisht jetonin në pjesën e Novobërdës së sotme (Artana) dhe në Prishtinë,

Diaspora hebreje në Evropë

Atdheu autokton i hebrenjve është në Lindjen e Mesme. Megjithatë, ata vazhdimisht dëboheshin nga aty prej pushtuesve dhe sunduesve të huaj. Në këtë mënyrë, hebrenjtë arritën në Evropë. Historikisht, hebrenjtë në Evropë ishin të ndarë në dy grupe kryesore: hebrenjtë ashkenazi, të cilët flisnin gjuhën jidish dhe kryesisht ishin të përqëndruar në Gjermani dhe tutje në lindje, dhe hebrenjtë sefardi, që flisnin gjuhën ladino. Hebrenjtë sefardi fillimisht jetonin në Spanjë dhe Portugali, në Gadishullin Iberik, nën sundimin arab. Marrëveshja e Umarit e vitit 720 ofroi një status vasal edhe për të krishterët edhe hebrenjtë, të cilët nuk lejoheshin të ngrisinin zërin gjatë kohës së lutjeve tyre e as të ndërtonin kisha ose sinagoga të reja. Megjithatë, nga shekulli VIII deri XI, në gadishullin iberian, nën sundimin arab, hebrenjtë ishin pranuar nga shoqëria dhe dhanë kontribut të madh në ekonomi, shkencë dhe kulturë. (Kjo kohë nganjëherë quhet edhe “Koha e Artë e Kulturës Hebreje në Spanjë”).


Në Evropën e mesjetës, komunitetet hebreje ishin vazhdimisht të trajtuar nga shumicat si “kurban” (fajtori kryesor) dhe nganjëherë obligoheshin të mbanin një shenjë dalluese. Me fillimin e kryqëzatave dhe me shpërthimin e murtajës (e ashtuquajtura “vdekja e zezë” pas vitit 1348), hebrenjtë u ndoqën dhe u dëbuan nga Anglia (1290), Franca (shekulli XIV) si edhe nga Spanja dhe Italia dhe nga disa territore italiane dhe gjermane (shekujt XV, XVI). Shumë hebrenjë ashkenazi gjetën strehim në shtetin polako-lituanëz ku përbënin komunitetin më të madh hebre në Evropë, derisa shumë nga hebrenjtë sefardi u shpërndanë nëpër perandoritë arabe dhe në Perandorinë Osmane.



Ndjekja e hebrenjve nga Spanja

pas rënies së Emirateve të Granadës në 1492, fortës e fundit - në Gadishullin Iberik, hebrenjtë sefardi që refuzuan të konvertohen në krishterizëm u dëbuan nga Spanja dhe Portugalia. Ata që refuzuan të konvertohen u persekutuan dhe u detyruan të shpërnguleshin.

Burimi:
<https://wellcomecollection.org/works/mjwa6gf4>



Zonat dhe datat e dëbimit të hebrenjve

Burimi:
<https://fcit.usf.edu/holocaust/PEOPLE/displace.htm>

Hebrenjtë në Perandorinë Osmane

Shumë hebrenj që u ballafaquan me përndjekje në vendet tjera, u vendosën në Perandorinë Osmane, dhe një numër i konsiderueshëm i tyre gjeti strehim në Ballkan. Sulltan Bajazidi i II-të (1481-1512) ishte posaqërisht miqësor ndaj hebrenjve. Autoritetet osmane e njohën të drejtën e hebrenjve për të praktikuar religjionin dhe ritualet e tyre dhe për të zhvilluar kulturën e tyre të posaçme. Një numër posaqërisht i madh i hebrenjve ishte i koncentruar në Selanik (Greqi) ku përbënin deri 68% të të gjithë popullatës së qytetit. Një nga komunitetet më të mëdha hebreje jetonte në Stamboll. Hebrenjtë në Perandorinë Osmane kishin profesione të ndryshme si bankierë, tregtarë, mjekë, etj., dhe jepnin kontribut të madh në zhvillimin e qyteteve. Ata arritën të marrin pozita me rëndësi në politikë, diplomaci dhe shkencë.

Tolerancë, emancipim apo asimilim?

Në të shumtën e rasteve, hebrenjtë që jetuan në Evropë u toleruan nga shumica në shoqëri. Përkundër kësaj tolerance, paragjykimet anti-hebreje ose anti-semitike dominuan dhe u shndërruan në dhunë fizike (siç ishin pogromet), ose politika antihebreje (siç ishte përndjekja e tyre nga Spanja) Gjatë mesjetës, shumë shtete i jepnin hebrenjve më pak të drejta se sa popullatës shumicë.

Një ndryshim i madh ndodhi me fillimin e Revolucionit Francez; hebrenjve iu dhanë të drejta civile, të barabarta me banorët tjerë, në Francë në 1791 e më vonë në shtetet tjera evropiane, gjatë shekullit XIX. Ky zhvillim quhet “emancipimi i hebrenjve”. Gradualisht, kjo u përkrah duke u përvetësuar në shumicën e shteteve evropiane me kushtetutat e tyre moderne të cilat garantojnë të drejta dhe liri të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht religjionit të tyre.

Një nga rrjedhojat e emancipimit të hebrenjve ishte edhe lajmërimi i lëvizjes së quajtur “Haskalah” (“Iluminizmi hebre”). Hebrenjtë e mirë-edukuar dhe me ndikim që jetonin në Evropë, kryesisht në Gjermani por edhe shtete tjera evropiane, e përkrahën këtë lëvizje dhe inkurajuan hebrenjtë të mësojnë gjuhët evropiane dhe të pranorin disa nga shprehitë e popullatave shumicë me të cilat jetonin. Kjo dërgoi në një asimilim të një pjese të madhe të popullatës hebreje nëpër shtetet ku jetonin. Në fillim të shekullit XX, shumë nga ata hebrenj më me dëshirë identifikoheshin si “gjermanë”, “francezë”, “austriakë”, “hungarezë”, etj., sesa si “hebre”.

Ky zhvillim ndodhi kryesisht në mesin e elitës hebreje në Evropën Perëndimore dhe Qendrore, por shumica e hebrenjve në këtë rajon edhe më tutje mbeti më shumë konzervative ose tradicionale. Shumica e hebrenjve evropianë jetonin në Evropën Lindore. Aty, situata ishte shumë më ndryshe.

Pogromet kundër hebrenjve në Perandorinë Ruse

Deri në fillim të shekullit XIX, shumica e diasporës hebreje jetonte në Evropën Lindore. Pas ndarjes së shtetit polako-lituanes në fund të shekullit XVIII, një numër i madh i hebrenjve që jetonin në ato territore ranë nën sundimin rus. Autoritetet ruse filluan të imponojnë shumë kufizime ligjore ndaj tyre, përfshirë formimin e hapësirave të posaçme ku hebrenjtë detyroheshin të jetonin. Shtypja e popullatës hebreje nën sundimin rus u rrit pas vrasjes së perandorit Aleksandrit i II-të (1881) kur autoritetet ruse, duke përdorë hebrenjtë si “kurban” për atentatin, vendosën ligje antihebreje dhe ndërmorrën një varg të pogromeve kundër hebrenjve. Kjo rezultoi me një shpërngulje masive të hebrenjve në Shtetet e Bashkuara, dhe në rajonet perëndimore të Evropës. Shumë hebrenj nga Perandoria Ruse migruan dhe u vendosën edhe në Perandorinë Osmane.

Jeta e hebrenjve në mes të dy Luftrave Botërore

Në mes të dy Luftrave Botërore, gati nëntë milion hebrenj jetonin në shumicën prej shteteve evropiane. Gjendja e hebrenjve dallonte shumë, nga plotësisht të asimiluar, mirë të edukuar, urbanë, në njërin anë, deri në të ndarë, ortodoksë fetarë dhe rural në anën tjetër.

Shumica e hebrenjve jetonte në Evropën Lindore: në Poloni, Bashkimin Sovjetik, Hungari, Rumani, etj. Aty, shumë prej tyre jetonin të ndarë nga shoqëria, në fshatra ose qytete të vogla të quajtura “shtetl”, që në fakt ishte një model i posaçëm shoqëro-kulturor. Këto komunitete e ruajtën traditën dhe religionin e tyre, veshnin rroba karakteristike, dhe udhëheqeshin nga një këshill. Anëtarët e tyre ishin të përfshirë në punë të ndryshme, kryesisht në tregti dhe zanate. Ata flisnin gjuhën jidish, që është një kombinim i elementeve kryesisht nga gjermanishtja dhe hebraishtja; ata lexonin libra në këtë gjuhë dhe shkonin në teatro e kinema me shfaqje në këtë gjuhë. Megjithatë, në qytete me të mëdha, shumë të rinj hebre u asimiluan në mënyra të reja të jetës dhe të të veshurit të popullatave shumicë.

Jeta hebreje në Rusi

Mary Antin për jetën e saj si një vajzë e vogël në Rusi, 1890

Cari gjithmonë na dërgonte urdhra (...) deri sa na mbeti shumë pak çka mund të bënim, pos të paguanim haraçin e të vdisim (...). Në ndonjë ditëlindje mbretërore, secila shtëpi duhej të ngriste flamurin, përndryshe pronari tërhiqej deri në stacion policorë dhe dënohej njëzet e pesë rubla. Një plakë e zhgënjyer, që jetonte e vetme në një kasolle të rrënuar, që jetonte nga ndihmat prej fqinjëve, i bëri kryq duart e saj të paralizuara një ditë kur u urdhërua ngritja e flamurëve, dhe priste fundin e saj, sepse nuk kishte flamur. Një polic vigjilent e hapi derën duke e goditur me çizmen e tij të madhe, mori jastëkun e fundit nga shtrati, e shiti, dhe siguroi një flamur dhe e vendosi mbi kulmin e kalbur. (...) Kishte një shkollë publike për djemtë, dhe një për vajzat, por fëmijët hebrenj pranoheshin në numër të kufizuar – vetëm dhjetë nga njëqind; e edhe ata fatlumët kishin telashe. (...) Kishte provim të veçantë për kandidatët hebrenj, natyrisht: një fëmijë nëntë vjeçar hebre duhej t’ju përgjigjes pyetjeve të cilat do të ishte vështirë të prisje t’ju përgjigjej edhe një jo-hebre trembëdhjetë vjeçar. Por kjo nuk kishte shumë rëndësi; ju përgatisnin për testin e një trembëdhjetë vjeçari. Pyetjet të dukeshin mjaft të lehta. I shkruaje përgjigjet duke u ndjerë fitimtar – e merrje notë të dobët, dhe nuk kishte mundësi ankese.

Burimi: <https://Burimibooks.fordham.edu/mod/1890antin.asp> (qasja 26.02.2020)

Antijudaizmi kthehet në antisemitizëm

Historiani gjerman Ulrich Wyrwa shkruan:

Gjatë shekullit XIX, popullata hebreje kishte arritur një ngritje të shpejtë shoqëro-ekonomike në pjesë të mëdha të Evropës. Shumica prej tyre më nuk ishin grup i dobët kryesisht i marginalizuar në shoqëri; tashmë ata paraqisnin një segment të suksesshëm social dhe ekonomik të shoqërisë. Hebrejtë ia kishin bërë avancimin e tyre shoqëror jo vetëm kapitalit simbolik të edukimit, por mbi të gjitha kompetencave të tyre në tregti, pikërisht ajo pjesë e ekonomisë e cila ishte më pak e rëndësishme në botën para-industriale dhe në të cilën hebrejtë u detyruan, jo më pak edhe nga stigmatizimi negativ i lidhur me tregtinë. Në moment historik kur përmes industrializimit dhe urbanizimit tregtia u bë sektor kyç i ekonomikë, marginalizimi i hebrenjve rrjedhimisht u shndërrua në pozitë të avancuar në shoqërinë e konsumatorit, që po rritej. Antisemitizmi e shënjestroi jo më pak këtë sukses ekonomik dhe avancim shoqëror të popullatës hebreje në një kohë kur segmente tjera të shoqërisë ndjeheshin që ishin në rrëmuje; në të njëjtën kohë, hebrejtë fajësoheshin për të gjitha trazirat shoqërore dhe pasiguritë që kaplonin jetën e përditshme të ndërlidhur me industrializimin.

Burimi: <https://nbn-resolving.org/urn:nbn:de:0168-ssoar-377395> (qasje 26.02.2020)

Jeta e hebrenjve në shtetet evropiane si Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Danimarka, Belgjika, etj., ishte ndryshe. Në këto shtete, hebrejtë ishin më të integruar, bile edhe të asimiluar në kulturën dominuese. Ata visheshin dhe flisnin gjuhën e njëjtë si edhe fqinjtë e tyre johebre. Jeta tradicionale fetare dhe kultura jidish luante rol më pak të rëndësishëm dhe nuk ishte aq e dukshme në këto rrethina.

Në Gjermani, në fillim të viteve '30 të shekullit të kaluar, kishte rreth 500,000 banorë hebrenj, që ishte 0.8% e popullsisë së përgjithshme. Rreth 70% prej tyre jetonte në qytete më të mëdha si Berlin, Frankfurt, Breslau etj. Në përgjithësi, popullata hebreje ishte e integruar në shoqërinë gjermane. Atje, shumica e hebrenjve e konsideronte veten si patriotë besnikë, të lidhur me mënyrën gjermane të jetesës përmes gjuhës dhe kulturës. Ata shkëlqyen në shkenca, letërsi, arte dhe në ndërmarrjet e biznesit. Suksesi i tyre ishte i dukshëm nga fakti që 24% të fituesve të Çmimeve Nobel nga Gjermania ishin hebrenj.

Kapitulli 1: USHTRIME PËR NXËNËSIT

1

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Të kuptuarit dhe definimi i koncepteve të “stereotipeve”, “paragjytimeve” dhe “diskriminimit”, duke ndërlidhë anti-judaizmin dhe antisemitizmin me rrëfime tjera diskriminuese/raciste. Theksimi i përshkallëzimit nga stereotipet në paragjytime pastaj në diskriminim dhe dhunë të mundshme.

Porosia kryesore:

Hebrenjtë kanë qenë (dhe ende janë) të përshkruar në mënyrë stereotipe, dhe prandaj shpesh janë trajtuar bazuar në imazhe të përgjithësuara dhe të thjeshtëzuara.

Stereotipet (idetë e pranuar, përgjithësimet) dhe paragjykimet (gjykimet e përgjithësuara) shpesh dërgojnë në diskriminim (margjinalizim, trajtim ndryshe), që përfshinë dhunën (dëmtimin fizik dhe psikologjik).

Ne të gjithë kemi stereotipa dhe paragjytime: me rëndësi është që t'i njohim ato dhe t'i sfidojmë duke qenë të hapur ndaj “të tjerëve”.

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri në 5 anëtarë). Secilit grup i jepet një kopje e karikaturës së hebrenjve. Në fund të pjesës c. (ose në fund të secilës pjesë), secili grup paraqet përgjigjet e veta në diskutim plenar.

Në këtë njësi mësimore, i shikuar anti-judaizmin dhe antisemitizmin si forma të paragjykitimit dhe diskriminimit. Bazuar në atë që keni mësuar, diskutoni pyetjet si vijon:

- Shiko karikaturën: Si duken hebrenjtë? Çfarë do të thotë kjo? Pse, sipas mendimit tënd, ata janë paraqitur në këtë mënyrë?
- Mendo për komentet që i dëgjuat lidhur me hebrenjtë; Prej nga e kanë zanafillën këto komente? A mendon se këto komente janë stereotipa? A do t'i definoje si “anti-semitike”?
- A mund të gjeshë shembuj tjerë të paragjytimeve dhe stereotipave ndaj grupeve tjera? Cilët janë shkaktarët e tyre? Cilat mund të jenë pasojat? A duhet të kemi një mendim të vetëm, të përgjithësuar për një grup?

MATERIALI E KOHA

SHTOJCË 1: Dy karikaturat e hebrenjve (një për secilin grup të nxënësve)

Fjalori: definicionet e stereotipave dhe paragjytimeve

35 min a: 10 min b: 10 min c: 15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: XII

2

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Shqyrtimi kritik dhe të kuptuarit e “antijudaizmit” dhe “antisemitizmit”, dhe identifikimi i ngjashmërive/dallimeve me forma tjera të racizmit.

Porosia kryesore:

Anti-judaizmi dhe antisemitizmi janë forma të paragjykitimit, të cilat progresivisht çuan në Nazi ideologjinë raciste, që ishte bazë për Holokaustin.
Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe të vogla (ose në çifte). Secilit grup i jepet definicioni për “antijudaizëm” dhe “antisemitizëm” (në formë të shkruar). Në fund të pjesës b., secili grup paraqet përgjigjet e veta në diskutim plenar.

Bazuar në definicionet e ofruara në tekst, diskutoni pyetjet si në vijim:

- Krahaso definicionet e “antijudaizmit” dhe “antisemitizmit”. Cilat janë dallimet? Cilat janë elementet e përbashkëta?
- Mendo për forma tjera të racizmit: si krahasohen

MATERIALI E KOHA

Definicionet e antijudaizmit dhe antisemitizmit (në tekst)

25-30 min a: 10-15 min b: 10-15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: XII

3

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Të kuptuarit se cilat forma mund të paraqiten nga procesi i “takimit” në mes të kulturave/religjioneve të ndryshme, gjatë shqyrtimit të pozicionimeve të ndryshme personale dhe shoqërore, pasojat e tyre, si edhe kompleksiteti i këtyre dinamikave.

Porosia kryesore:

Hebrenjtë përjetuan trajtim të ndryshëm në vende të ndryshme gjatë mesjetës. Politikat e miratuara kundrejt tyre patën një ndikim të fuqishëm në rrjedhat e migrimit dhe në shkallën e integritetit të komuniteteve hebreje në shoqëritë tjera.

“Takimi” dhe “përzierja” e kulturave të ndryshme ndërlikohet me dinamika komplekse dhe procese afat-gjate të përcaktuar nga shumë faktorë. Përbrenda kësaj kornize, është e domosdoshme të sigurohet respekt i të drejtave dhe mirëqenies së të gjitha grupeve dhe komuniteteve (diversiteti kulturor).

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

SNxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë). Në fund të pjesës c. (ose në fund të secilës pjesë), secili grup paraqet përgjigjet e veta në diskutim plenar (nëse premtan koha).

Bazuar në njohuritë e fituara lidhur me hebrenjtë në Evropë, diskutoni pyetjet si në vazhdim:

- Si ishte gjendja e hebrenjve në vende të ndryshme në mesjetë dhe gjatë kohëve moderne?
- Çfarë mund të ndodhë kur takohen kultura ose religjione të ndryshme?
- Cilat janë dallimet midis “tolerancës”, “asimilimit”, “emancipimit” dhe “integritetit”?
- Cilët shembuj tjerë mund t’i ofroni gjatë të menduarit për këto dukuri? Për shembull, a njeh dikë që ka emigruar në shtete tjera? Çfarë i ka ndodhë atij/asaj? (p.sh., kosovarët në Zvicër/Gjermani)

Ndani përvoja të anëtarëve të familjes ose shoqërisë.

MATERIALI E KOHA

Nuk nevojitet material

40 min a: 10 min b: 15 min c: 15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: XII c: XII

4

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Analizim në mënyrë kritike i politikave të kundërta të adoptuara ndaj hebrenjve në mesjetë, dhe pasojat e tyre.

Porosia kryesore:

ozita e hebrenjve në mesjetë ndryshonte nga vendi në vend (p.sh., Mbretëria e Spanjës krahas Perandorisë Osmane). Si në rastin e hebrenjve në mesjetë, sistemet politike dhe vendimet kanë ndikim të fuqishëm në jetët dhe kushtet e individëve (të qytetarëve të atij vendi dhe të huajve).

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë). Në fund të pjesës b., secili grup paraqet përgjigjet e veta në diskutim plenar. Bazuar në tekstet, shqyrtoni dhe krahasoni dy politikat (Dekreti për dëbimin e hebrenjve dhe politika e Sulltan Bajazidit të II-të). Diskutoni pyetjet si më poshtë:

- Çfarë kuptoni nga tekstet? Si ishin dy pozicionimet të ndryshme? Pse?
- Cilat ishin, sipas mendimit tuaj, pasojt e dy politikave ndaj hebrenjve? Çfarë bënë familjet hebreje kur këto dy politika hynë në fuqi? Diskutoni të dy mundësitë

MATERIALI E KOHA

SHTOJÇË 2: Tekstet e Dekretit të Dëbimit dhe Politikës së Sulltanit

20-25 min a: 10-15 min b: 10 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX (dhe XII) b: IX (dhe XII)

5

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Kuptimi i konceptit të “scapegoat” (kurban, fajtor kryesorë) dhe pasojat e saj.

Porosia kryesore:

“Scapegoating” (kurban) është një mënyrë e pasaktë, e padrejtë dhe e thjeshtëzuar e përshkrimit të një problemi ose realiteti. Është me rëndësi të shqyrtohet situata, të njihen shkaktarët dhe të pranohen përgjegjësitë e të gjithë hisedarëve (përfshirë neve).

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Teksti përmend se hebrenjtë u përdorën si “fajtorë kryesorë” në raste të ndryshme në të kaluarën.

Bazuar në atë çfarë mësuat, diskutoni pyetjet si në vazhdim:

- Çfarë nënkupton kjo shprehje/ky koncept? Prej nga e ka zanafillën?
- A di ti për shembuj tjerë të “scapegoating” (kurban)? A mund ta ndërlihdësh këtë koncept me ngjarje/histori tjera tradicionale që i ke dëgjuar?
- Cilat janë pasojat e “flijimit të fajtorit kryesor”?

MATERIALI E KOHA

Nuk nevojitet material, lidhje në internet për hulumtim lidhur me shprehjet/konceptet

30 min a: 10 min b: 10-15 min c: 5-10 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: IX dhe XII c: IX dhe XII

SHTOJCA 1:

Karikatura për hebrenjtë



Burimi: <https://opensiddur.org/wp-content/uploads/2018/03/jewstereotype.jpg>



Burimi: www.myjewishlearning.com/article/what-were-pogroms

SHTOJCA 2:

Nxjerrë nga Dekreti për Dëbimin e Hebrenjve (1492)

“...Prandaj, ne, në diskutim dhe këshillim me klerikët tanë, me fisnikë të mëdhenj të mbretërive tona, dhe persona tjerë të dijes dhe urtësisë të Këshillit tonë, pasi e kemi shqyrtuar këtë çështje, kemi vendosur t'i urdhërojmë hebrenjtë e mbretërive tona, meshkuj e femra, to largohen dhe kurrë të mos kthehen, në asnjërin prej mbretërive tona. Dhe në lidhje me këtë ne urdhërojmë që të merret ky aktvendim i joni, me të cilin i urdhërojmë të gjithë hebrenjtë, meshkuj e femra, të cilës do moshë, që jetojnë, kanë vendbanim, ose ekzistojnë në mbretëritë dhe pronat tona, si ata që janë vendas si ata që s'janë, të cilët sido apo për çka do që kanë ardhë, se deri në fund të muajit korrik të vitit që po vjen – që të largohen nga të gjitha pronat dhe mbretëritë tona të përmendura, bashkë me djemtë dhe vajzat e tyre, shërbëtorët dhe shërbëtoret, familjarët hebre, ata që janë të ngritur si edhe popull i zakonshëm, të cilës do moshë ata të janë, dhe të mos guxojnë të kthehen në këto vende, as të vendosen në to, as të jetojnë në ndonjë pjesë të tyre, as përkohësisht – rrugës për diku tjetër, as në ndonjë mënyrë tjetër, nën dhimbjen e asaj/kërcënimit që, nëse nuk veprojnë sipas këtij vendimi dhe nuk i nënshtrohen atij, dhe gjenden në mbretëritë e pronat tona si, në çfarëdo mënyre, jetojnë aty, do t'ju zbatohet dënimi me vdekje dhe konfiskim i të gjitha posedimeve të tyre nga Dhoma jonë për Financa, duke zbatuar dënimet përmes këtij akti, pa ndonjë gjykim apo deklaratë tjetër. Dhe, urdhërojmë e ndalojmë që asnjë person apo grup i mbretërive të përmendura, me çfarëdo pasurie, gjendje, apo dinjiteti që mund të kenë, nuk guxon të pranojë, mbrojtë, ose mban, publikisht apo fshehtas, asnjë hebre, mashkull apo femër, prej ditës së fundit të korrikut e përgjithmonë, në tokat e tyre, shtëpitë a në pjesë tjera të cilës do prej mbretërive dhe pronave tona të përmendura, nën dhimbjen e asaj/kërcënimit që, do të humbasin të gjitha posedimet e tyre, vasalët, hapësirat e fortifikuara dhe trashëgimitë tjera e pos kësaj humbin edhe çfarëdo granti financiar që marin nga ne përmes Dhomës tonë për Financa.”

Burimi: <http://www.sephardicstudies.org/decreet.html> (Translated from Castilian by Edward Peters)

Politika e Sulltan Bajazidit të II-të

Gjatë viteve 1490 deri 1497 Sulltan Bajazidi i II-të i pranoi hebrenjtë e ndjekur nga Italia, Spanja dhe Portugalia. Në vitin 1492, Kemal Reis dhe flota e tij u dërguan në qytetin Kadiz (Spanjë) për të marrë përsipër hebrenjtë. Gjatë sundimit të Bajazidit II-të, mbreti dhe mbretëresha e Spanjës, Ferdinand dhe Isabella, nënshkruan një dekret për dëbimin e hebrenjve. Nën presionin e kishës, dekreti u nënshkrua më 31 mars 1492 dhe hebrenjtë u deshën ta lëshonin vendin deri më 2 gusht 1492. Grupi i fundit i hebrenjve që u mbledh portin e Kadizit u ballafaqua me një dilemë: Ata që largoheshin nga porti sulmoheshin nga piratët, ata që shkonin në tokë digjeshin në hunjnga inkuizicioni. Rreth njëmijë njerëz pritnin në ankth. Në minutin e fundit arriti një flotë e vogël e udhëhequr nga admirali turk Kemal Reis, i cili i mori refugjatët në mbrojtjen e vet. Ky ishte një konvoj i organizuar i emigrantëve hebre drejt Perandorisë Osmane. Nga rreth 600,000 hebrenj spanjollë, gjysma u kryqëzuan, 100,000 shkuan në Portugal, disa shkuan në Holandë, Itali, Afrikën Veriore dhe në Botën e Re. Por, pjesa më e madhe e tyre, rreth 150,000 njerëz, arriti në Perandorinë Osmane. Kur edhe hebrenjtë që kishin shkuan në Portugali u dëbuan në vitin 1497, shumica prej tyre gjetën strehim në Perandorinë Osmane. Ndërsa emigrimi i hebrenjve të konvertuar dhunshëm në tokat osmane zgjati disa dekada. Në vitin 1501 Sulltan Bajazidi II-të i pranoi hebrenjtë që ikën nga Franca. Në periudha të mëvonshme, hebrenjtë me origjinë nga Spanja dhe Portugalia që kishin shkuar në Brazil, u ndoqën me rrugë ligjore, dhe i detyruan të emigrojnë në Amsterdamin e Ri, New Yorkun e sotëm.

Burimi: <http://www.sephardicstudies.org/sultans1.html>

Kapitulli 2

Holokausti

Shprehja “Holokaust” vjen prej dy fjalëve greke që përafërsisht përkthehen si “flijim Zotit, me zjarr”. Shprehja më vonë u përdor për të përshkruar shfarosjen e hebrenjve të ndodhur mes viteve 1941 dhe 1945. Megjithatë, shumë institucione e definojnë këtë term si të tillë që përfshinë edhe grupe tjera të viktimave ose persekutimet që ndodhën para vitit 1941. Vet hebrenjtë preferojnë të përdorin shprehjen “Shoah” që është një fjalë hebraike nga Bibla me kuptimin “fatkeqësi”. Vlerësohet se rreth 6 milionë hebrenj, rreth dy të tretat e të gjithë hebrenjve evropianë, u asgjësuan – një krim që shkaktoi traumë të pamasë kolektive për shumë hebrenj dhe e ndryshoi historinë botërore. Si ka mundur të arrinte antisemitizmi në atë shkallë të ndjekjes dhe shfarosjes? A ka mundur Holokausti të parandalohet ose të ndalej?

Ligji për mbrojtjen e gjakut gjerman dhe nderit gjerman, i 15 shtatorit 1935

I prekur nga të kuptuarit se pastërtia e gjakut gjerman është kushtihelbësor për vazhdimin e ekzistencës së popullit gjerman, dhe ifrymëzuar me vendosmërinë e pa luhatur për të siguruar ekzistencën e kombit gjerman për të gjitha kohët, Reichstag (Parlamenti) unanimisht aprovoi ligjin si vijon, me të cilin shpallet se:

Neni 1

1. Martesat në mes të hebrenjve dhe subjekteve të shtetit të Gjermanisë ose në lidhje gjaku me ta, janë të ndaluara. Martesat që lidhen përkundër kësaj janë të pavlefshme, edhe nëse martesa bëhet jashtë shtetit, për të anashkaluar këtë ligj.
2. Procedurat e anulimit (të martesës) mund të nisen vetëm nga prokurori i shtetit.

Neni 2

marrëdhëniet jashtëmartesore në mes të hebrenjve dhe subjekteve të shtetit gjerman ose në lidhje gjaku me ta janë të ndaluara. [...]

Neni 5

1. Secili person që thyen ndalesën nën Nenin 1 do të dënohet me burg me punë të rëndë.
2. Një burrë që thyen ndalesat nën Nenin 2 do të dënohet me burgim ose burg me punë të rëndë. [...]

Burimi: <https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/article/nuremberg-laws>

Ngritja e nazistëve në Gjermani

Humbja e Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore, Traktati pasues i Versajës që i kërkonte asaj të paguante dëmshpërblime masive si kompensim për luftën, dhe kriza ekonomike që preku gati gjithë botën, e la Gjermaninë në një gjendje dëshprimi dhe ankthi. Partitë ekstreme arritën rezultat të mirë zgjedhor, koalicionet qeverisëse nuk zgjatnin shumë, dhe pati disa tentativa për grusht-shtet. Një nga partitë radikale ishte Partia Naziste. Në përpjekje për të krijuar një qeveri stabile, udhëheqësi nazist, Adolf Hitler u caktua Kancelar (Kryeministër) i Gjermanisë në janar 1933, pas fitores së tij në zgjedhje.

Partia Naziste shpejt vazhdoi të marrë kontrollin e të gjitha institucioneve shtetërore, të konsolidojë forcat e veta dhe të propagandojë ideologjinë e vet. Thelbi i asaj ideologjie ishte përshkruar në librin e Hitlerit “Mein Kampf” (“Lufta ime”). Në të, Hitleri pohon se gjermanët i takojnë racës “Ariane”, që është më superiore se tjerat, prandaj, meritojnë të sundojnë botën. Si rrjedhojë, nazistët e zgjeruan Rajhun Gjerman, duke aneksuar Austrinë në 1938, që përkrahej me të madhe nga shumë austriakë, dhe pjesë të Çekosllovakisë ku populli gjerman përbënte një pakicë të madhe. Kjo fillimisht u kundërshtua nga qeveria Çekosllovake por kishte pajtimin e Francës dhe Britanisë së Madhe në “Marrëveshjen e Munihut”.

Në nazi ideologjinë raciste, njerëzit që definoreshin si sllavë llogariteshin si inferiorë në krahasim me arianët ndërsa ata që konsideroheshin hebrenj ishin më të pavlefshmit. Për gjendjen e vështirë të Gjermanisë, nazistët fajësonin konspiracionin hebre, duke i shndërruar ata në armiq që duhet ndjekur.

Ligjet e Nurembergut

Në atë që mund të konsiderohet të jetë faza e parë e këtij persekutimi, baza ligjore ishte përgatitur për të trajtuar hebrenjtë ndryshe nga të gjithë qytetarët tjerë gjermanë. Në 15 shtator 1935, “Ligjet e Nurembergut” u aprovuan duke i shërbyer qëllimit të ndarjes së shoqërisë gjermanë në hebrenj dhe jo-hebrenj. Ata e përcaktuan si hebre secilin person me së paku një gjysh hebre. Kjo ishte e kundërt me faktin se shumë prej këtyre njerëzve e identifikonin veten si gjerman dhe të traditës religjioze hebreje, sipas së cilës një hebre gjithmonë lind nga nëna hebreje. Tutje, këto ligje ju hoqën hebrenjve shtetësinë e tyre gjermane. Dekretet pasuese kufizuan tutje lirinë e hebrenjve, i diskriminuan dhe ju kufizuan qasjen në shërbime dhe në jetën publike. Ligje të ngjashme, të shkallëve të ndryshme të diskriminimit u sollën edhe në vitet pasuese nga shtetet tjera që dolën

krah Gjermanisë. Pasi filloi lufta, këto ligje u zbatuan në territoret e okupuara nga Gjermania ose të aneksuara nga ajo dhe aleatët e saj.

“Kristallnacht” (“Nata e kristaleve”)

Pasi që hebrenjt u ndanë nga pjesa tjetër e shoqërisë, nazistët filluan ta legjitimojnë dhe banalizojnë dhunën fizike ndaj tyre. Më 7 nëntor 1938, një diplomat gjerman u vra në Paris nga hebrenjt. Kjo ngjarje u përdor nga nazistët si pretekst për organizimin e pogromit kundër hebrenjve në të gjithë Reich-un, më 9 dhe 10 nëntor 1938, të cilën propaganda naziste e quajti “Kristallnacht” (“Nata e kristaleve”). Emri iu dha sipas pjesëve të xhamave që kishin mbuluar rrugët si pasojë e thyerjes së dritareve të sinagogave, bizneseve hebreje, dhe shtëpive të tyre. Ato u plaçkitën, shkatërruan dhe dogjën. Për dy ditë, pa ndonjë kundërshtim të dukshëm nga popullata gjermane, rreth 99 hebrenj u vranë, 267 sinagoga u shkatërruan, rreth 7500 shtëpi hebreje, biznese dhe hapësira komerciale u demoluan, gjithashtu edhe varrezat hebreje u përdhosën nga simpatizantët e Partisë Naziste. Rreth 30,000 hebrenj u arrestuan dhe u dërguan në kampe përqendrimi.


“Kristallnacht” ju demonstroi shumë hebrenjve në Rajhun Gjerman se ata nuk ishin më të sigurt dhe se, si rezultat, rreth 100,000 hebrenj migruan për ta shpëtuar veten. Disa ikën në Jugosllavi, e disa gjetën strehim në Shqipëri. Në rastin e Shqipërisë, dokumentet si letra e Legatës Mbretërore të Shqipërisë në Berlin e dërguar menjëherë pas “Kristallnacht” nga një biznesmen hebre, tregon se Mbreti Zogu i I-rë i mirëpriti refugjatët hebrenj të shkonin në shtetin e tij për strehim dhe mbrojtje. Fatkeqësisht, nuk ka shumë dokumente të qasshme që do të sqaronin motivimin e tij për këtë veprim. Në rastin e kësaj letre, duket e mundur se kishte edhe një interes ekonomik në kërkimin e refugjatëve të kualifikuar dhe bizneseve të tyre të migronin në Shqipëri.



Gjermanët kalojnë pranë një vitrine të thyer dyqani të një biznesi me pronar hebre, të shkatërruar gjatë Kristallnacht

Burimi:

<https://collections.ushmm.org/search/catalog/pa16792>



Letër nga Legata Mbretërore e Shqipërisë në Berlin dërguar Z. Ekrem Libohovës,
Ministër i Punëve të Jashtme i Mbretërisë së Shqipërisë, 1 janar, 1939

Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore dhe shtimi i politikave antisemitike

Lufta e Dytë Botërore shpërtheu më 1 shtator 1939 kur Polonia u pushtua dhe u mposht nga gjermanët. Lufta u nxit nga ideologjia e njëjtë raciste e bazuar në besimin se “raca superiore Gjermane” meritonte të drejtën të sundojë mbi të gjitha racat tjera dhe ka nevojë për më shumë “Lebensraum” (“hapësirë jetese”). Si rrjedhojë, forcat gjermane okupuan pjesë të mëdha të Evropës e përtej. Armata gjermane përkrahej nga “forcat e Boshtit”, që ishin Italia dhe Japonia, në luftë kundër “forcave Aleate” të Britanisë së Madhe, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara. Qeveritë e shteteve evropiane ose iu bashkuan njërit prej këtyre blloqeve, ose mbetën neutrale. Kur ato shtete u okupuan nga Boshti, ato qeveriseshin ose nga liderët që ishin në favor të fuqive të Boshtit, ose nga Gjermani apo Italia, drejtpërdrejtë. Politikat antisemitike që ishin zbatuar në Gjermani u shpërndanë në të gjitha ato territore ku Boshti ishte në fuqi, ku u kryen në shkallë të ndryshme.

Getot

Vetëm një muaj pas fillimit të luftës, geto e parë u formua në tetor 1939. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shprehja “geto” filloi të përdoret për të gjitha lagjet ku hebrenjtë ishin të detyruar të jetonin, të ndarë nga pjesa tjetër e popullsisë, në izolim të ngjashëm me të burgosurit. Në këtë kuptim, kjo ishte një vazhdim i politikës naziste për përjashtimin e hebrenjve nga pjesa tjetër e popullatës, siç u iniciua me ligjet e Nurembergut. Hebrenjtë nga shumë territore nën sundimin gjerman u degdisën nëpër geto. Getoja më e madhe në Evropë ishte krijuar në Varshavë (Poloni) në nëntor 1940. Në Shqipëri dhe Kosovë nuk kishte geto.

Kushtet e jetesës në geto ishin të padurueshme. Mijëra hebrenj vdiqën në to nga uria, sëmundjet, puna e dhunshme dhe vrasjet. Me hapjen e kampeve të përqendrimit dhe të shfarosjes, funksioni i getove u shndërrua në një hapësirë për pritje të përkohshme para degdisjes në kampe.

Masakrat dhe “Zgjidhja Finale”

Pas pushtimit gjerman të Polonisë, njësitë ushtarake të quajtura “Einsatzgruppen” (“grupet për zhvendosje” ose “operacionale”) morën detyrën që të gjejnë dhe të vrasin hebrenjtë në territoret rishtazi të pushtuara. Pas pushtimit të Bashkimit Sovjetik, këto njësi kryen masakra të shkallës së lartë, siç ishte ajo në Babi Yar në Ukrainë, ku u vranë rreth 33,000 hebrenj. Në vend që të shqetësohej që qindra e mijëra burra, gra e fëmijë të pafajshëm po vriteshin, udhëheqja naziste ishte e brengosur se ky zhvillim do ta lodhte/sforconte/tendoste shumë ushtrinë e saj dhe do të dobësonte suksesin e Gjermanisë në luftë, e cila ishte intensifikuar më shumë në fund të vitit 1941.

Si pasojë, ata po shqyrtonin zgjidhe tjera për eliminimin e popullatës hebreje në Evropë. Zgjidhja që e gjetën ishte politika e quajtur “Zgjidhja Finale”, e aprovuar në janar 1942. Qëllim kishte asgjësimin sistematik të të gjithë hebrenjve në Evropë. Kjo do të arrihej me degdisjen e hebrenjve në kampe të përqendrimit dhe të vdekjes, ku do të vriteshin në mënyrë industriale, që do t’u ipte më pak shqetësim vrasësve të tyre.




Theresienstadt, Çekosllovakia, 1944, Shpërndarja e ushqimit në geto

Burimi:
https://photos.yadvashem.org/photo-details.html?language=en&item_id=101771&ind=0



Varshavë, Poloni, Një fëmijë i uritur në rrugët e getos, 1941.

Burimi:
https://photos.yadvashem.org/photo-details.html?language=en&item_id=23294&ind=0



Buchenwald, Gjermani, të burgosurit në Baraka pas çlirimit, prill 1945

Burimi:
https://photos.yadvashem.org/photo-details.html?language=en&item_id=100049&ind=0

Kampet e përqendrimit dhe të shfarosjes

Në mars 1933, kampi i parë i përqendrimit u hap në Dachau, Gjermani. Fillimisht shërbeu kryesisht për kapjen e kundërshtarëve politikë të Partisë Naziste, për “ri-edukim” të tyre ose për t’i detyruar në punë në kushte të tmerrshme, nën të cilat kushte shumë banorë të kampit vdiqën. Më vonë, më shumë kampe të përqendrimit u krijuan, sidomos në Poloni, dhe hebrenjt, romët, homoseksualët dhe të tjerë gjithashtu u dërguan atje. Në vitin 1942, si rezultat i politikës së “Zgjidhjes Finale”, disa kampe përqendrimi kishin të instaluara dhoma gazi dhe krematoriume. Në të njëjtën kohë, kampe tjera të “shfarosjes” u hapën në Belzec, Sobibor dhe Treblinka, të cilat u hapën ekskluzivisht për vrasje masive. Vetëm në këto tri kampe u vranë rreth 1.6 milionë hebrenj. Kampi Auschwitz-Birkenau u bë njëri ndër kampet më të mëdha dhe më famëkeq të shfarosjes.

Shumica e të degdisurve, sapo arrinin në Auschwitz-Birkenau, dërgoheshin në dhoma gazi menjëherë, derisa disa prej tyre zgjedheshin për punë të rënda. Në pranverë të vitit 1943, kampi kishte 4 dhoma gazi funksionale, që përdornin gazin helmues Zyklon B. Rreth 1.1 milionë hebrenj dhe dhjetëra e mijëra romë, polakë, të burgosur sovjetikë të luftës dhe të tjerë u vranë në Auschwitz-Birkenau.

Kampe përqendrimi kishte edhe në Ballkan. Më i rëndësishmi, kampi Jasenovac në Kroaci, që njihet edhe si “Auschwitz i Ballkanit”, u hap në gusht 1941. Nazistët gjermanë i dhanë kontrollin e kampit qeverisë kuislinge kroate, të udhëhequr nga “Ustashët” (Organizatë kroate fashite). Në kamp u vranë serbë, hebrenj, romë, kroatë dhe të tjerë. Në tetor 1941, kampi i përqendrimit Sajmishte u hap afër Beogradit, ku mijëra hebrenj u vranë. Për më shumë, një tjetër kamp përqendrimi ishte ai në Banjice, udhëhequr nga nazistët gjermanë dhe qeveria kukull serbe e Milan Nediqit.

Tregimi i një familje hebreje nga Varshava – në vitin 1943, Franciszka Rubinlicht ju shkroi motrave të veta që po jetonin të fshehura jashtë Getos:

“Qëndrimi ynë në kamp (në Geto) është një ankth. [...] Qëndrova në fabrikë gjithë natën, punoja 1 orë për 160 gramë të bukës së mykur dhe një kupë enëlarësi në vend të supës. Ky ishte ushqimi për gjithë ditën, si edhe paga jonë. Kjo nuk na lejonte të vdesim, por buhavitja nga uria i deformonte njerëzit e i bënte si kafshë [...] Nuk mund të braktisim punën, sepse do të kishte pasoja të rënda, prandaj as nuk kishte të sëmurë në kamp. Unë shkoja në punë me një temperaturë prej 39°, të tjerët tërhiqeshin zvarrë gjysmë të vetëdijshëm e të infektuar me tifo, derisa shtreshin se janë të shëndoshë sepse të sëmuret menjëherë pushkatoheshin me qëllim të ndalimit të sëmundjes.”

Burimi: Archiwum Żydowskiego Instytutu Historycznego [Archiv des Jüdischen Historischen Instituts], Sign. 301/485, S. 7–8, bearb. d. Verf.

Dëshmi për degdisjen në kamp:

Primo Levi u lind në Torino, Itali në 1919. Në dhjetor 1943, milicia fashiste italiane e zuri dhe e dërgoi në Auschwitz. Në 27 janar 1945, me çlirimin e kampit, ai u kthye në Itali. Autor i shumë librave për Holokaustin, në vitin 1987 ai vdiq, me siguri duke kryer vetëvrasje. “Dyert u mbyllën menjëherë, por treni nuk lëvizi deri në mbrëmje. E kishim mësuar destinacionin tonë me lehtësim. Auschwitz: një emër pa ndonjë rëndësi për neve në atë kohë, por së paku ishte një vend në tokë... Nëpër vrima, emra të njohur e të panjohur të qyteteve austriake (...), pastaj çeke, e në fund polake. Në mbrëmjen e natës së katërt të ftohtit u bë më i fortë: treni po lëvizte pandërprerë nëpër male të pishës së zezë (...) Bora ishte e lartë... Gjatë ndalesave, askush nuk provonte më të komunikojë me botën e jashtme: ndjeheshim tashmë ‘në anën tjetër.’”

Burimi: Primo Levi, *Nëse ky është njeri*, (New York: Orin Press, 1958, f. 8-10), marr nga The Auschwitz Album - A curriculum for High Schools, Yad Vashem, The International School for Holocaust Studies, Israel 2009, p.24

Çlirimi i Auschwitz-it dhe fundi i Luftës së Dytë Botërore

Holokausti përfundoi sepse forcat Aleate e fituan luftën. Derisa forcat Aleate po përparonin drejt Gjermanisë nga lindja dhe perëndimi, ata çliruan kampe e geto. Shumë roje të kampeve provuan të vrasin të burgosurit e mbetur, t'i detyronin të ecin deri në kampe tjera më afër Gjermanisë, të shkatërronin dëshmitë e krimeve të tyre ose të ilkin e të fshiheshin nga ndjekja në të ardhmen. Më 27 janar 1945, armata sovjetike hyri në Auschwitz. Për këtë arsye, 27 janari vazhdon të shënohet në mbarë botën si Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit. Gjermania u dorëzua më 8/9 maj 1945.

Deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, gati 6 milionë hebrenj u vranë, gjithashtu edhe miliona të tjerë, përfshirë sllavë, romë, homoseksualë, “personat asocial”, dëshmitarë të Jehovahit, disidentë politikë, njerëzit me të meta, dhe grupe tjera të konsideruara si “të ulëta”, përfunduan në të njëjtën mënyrë. Yad Vashem (Qendra Botërore e Përkujtimit të Holokaustit), bashkë me partnerët e vet, ka mbledhur dhe regjistruar emrat dhe detajet biografike të miliona viktimave.

Kapitulli 2: USHTRIME PËR NXËNËSIT

1

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Shqyrtimi i Ligjeve të Nurembergut dhe Holokaustit nga perspektiva e të drejtave të njeriut.

Porosia kryesore:

Politikat naziste kundër hebrenjve dhe grupeve tjera janë shkelje e të drejtave themelore të njeriut dhe të vlerave morale. Ligjet e Nuremberg-ut legalizuan diskriminimin kundër hebrenjve.

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë). Secilit grup i ofrohet një kopje e Ligjeve të Nurembergut (Ligji për mbrojtjen e gjakut gjerman dhe nderit gjerman, 1935). Në fund të pjesës b., secili grup paraqet përgjigjet e veta në diskutim plenar.

Për këtë detyrë, do të shqyrtojmë Holokaustin si një shkelje e rëndë e të drejtave themelore të njeriut. Bazuar në atë që keni mësuar dhe çfarë mund të hulumtoni online, diskutoni pyetjet në vijim:

- Shih Ligjet e Nuremberg-ut: Pse janë këto ligje diskriminuese? Çfarë nënkuptonte kjo për një hebre që jetonte në atë kohë?
- Cilat të drejta themelore u mohuan me Ligjet?

MATERIALI E KOHA

SHTOJCA 1: Ligjet e Nuremberg-ut (një kopje për secilin grup)

40 min a: 20 min b: 20 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: IX dhe XII

2

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Shqyrtimi i ndikimit dhe kuptimi i "Kristallnacht" si edhe hulumtimi i reagimeve të mundshme nga qytetarët, hisedarët relevantë dhe akterët institucionalë.

Porosia kryesore:

"Kristallnacht" shënoi pikë kthese në eskalimin e dhunës ndaj hebrenjve të promovuar nga nazizmi: gjatë asaj nate, hebrenjtë u vetëdijësuan për shkallën e rrezikut dhe përshkallëzimin e situatës.

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë). Secilit grup i jepen foto të "Kristallnacht" (1938) dhe letra e shkruar nga Arnold (Aharon) Rosenfeld. Në fund të pjesës b., secili grup prezanton përgjigjet e veta në diskutim plenar.

- Shih fotot dhe vendos veten në këpucët e ndonjë kalimtarit: Çfarë do të mendoje ose si do të veproje ti në kësi situatë?
- Lexo letrën: Çfarë mund të kenë qenë reagimet e mundshme të ambasadorit ose kryetarit amerikan? Çfarë do të ishin pasojat?

MATERIALI E KOHA

SHTOJCA 2: Foto të Kristallnacht dhe letra nga Rosenfeld (një kopje për secilin grup)

20-25 min a: 10 min b: 10-15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: IX dhe XII

3

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Njohja e kuptimit dhe rëndësisë së getos dhe kampeve në përshkallëzimin drejt Holokaustit dhe Zgjidhjes Finale; reflektim mbi atë se si ngjarjet nga e kaluara formësojnë shoqëritë sot.

Porosia kryesore:

Getot u përdorën nga nazistët për të veçuar hebrenjtë dhe grupet tjera duke i ndarë nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe duke ju mohuar të drejtat. Kampet, shkurt pas kësaj, shërbyen si plan nazist për shfarosje sistematike përmes punës së detyrueshme dhe asgjësimit fizik.

Vendet ku u kryen vrasjet në të kaluarën janë pjesë të qyteteve ku ne jetojmë sot: në disa raste, e kaluara e tyre mbahet mend, e në raste tjera është harruar ose e panjohur për gjeneratat e reja.

Për definicione, ju lusim referojë fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë). Secilit grup i ofrohe foto të getove dhe kampeve gjatë regjimit nazist dhe sot. Në fund të pjesës b., secili grup i prezanton përgjigjet e veta në diskutim plenar.

Bazuar në fotografi dhe shembuj tjerë të vendeve të përkujtimit për të cilat ti di, diskutoni pyetjet si në vijim:

- Shih fotot e getos dhe kampeve gjatë regjimit nazist: Çfarë mund të shohësh? Çfarë paraqesin këto vende për hebrenjtë? Pse u përdorën ato nga nazistët?
- Fokusohu në geto: a dini shembuj tjerë të getos dhe ndarjes që ekzistojnë sot?
- Shih në fotot "pas": Çfarë paraqesin këto vende sot? Si ju qasen njerëzit këtyre vendeve sot?

MATERIALI E KOHA

SHTOJCA 3: Foto të getos dhe kampeve të përqendrimit gjatë regjimit nazist dhe të vendeve të njëjta sot (një kopje për secilin grup)

35 min a: 15 min b: 10 min c: 10 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: XII c: XII

4

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Të kuptuarit e migrimit, shkaktarëve të tij dhe ndikimit i politikave të shtetit ku migrohet; ndërlidhja e përvojës së hebrenjve në fund të viteve të '30-ta me valët më të fundit të migrimit.

Porosia kryesore:

Mbretëria e Shqipërisë konsiderohej si vend i sigurtë për hebrenjtë, duke iu falënderuar politikave mikëpritëse: për këtë arsye shumë hebrenjë migruan nga shtetet Evropiane në Shqipëri në fund të viteve '30-ta dhe gjatë viteve '40-ta.

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe të vogla (2 ose 3 anëtarë). Grupeve ju ofrohet letra e shkruar nga Legata Mbretërore e Shqipërisë në Berlin, në emër të z. Kurt Haberland që kërkon strehim në Shqipëri (1939).

Nxënësit shkruajnë një përgjigje letrës, secili grup merr pozicionim të ndryshëm (shih udhëzimet më poshtë për luajtje të roleve). Kur të përfundojnë shkrimin e përgjigjeve të tyre, grupet i shkëmbejnë letrat dhe diskutojnë pozicionimin e kundërt.

- a. Grupet shkruajnë një përgjigje letrës, duke marrë pozicionime paraprakisht të caktuara:
 - Grupi 1: shkruaj një përgjigje pozitive, që i lejon një biznesmeni hebre nga Gjermania të zhvendoset në Shqipëri. Nënvizohet arsyet e vendimit tuaj.
 - Grupi 2: shkruaj një përgjigje negative, që refuzon kërkesën për azil. Nënvizohet arsyet për vendimin tuaj.
- b. A dini diçka për rrjedhat e tashme të migrimit? Cilat rregullore janë në fuqi? (p.sh., Rruga Ballkanike, ose emigrimi nga Kosova/Ballkani Perëndimor drejt shteteve të BE-së)

MATERIALI E KOHA

SHTOJCA 4: Letra nga Haberland (një kopje për secilin grup)

30 min a: 20 min b: 10 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: XII

5

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Shqyrtimi në mënyrë kritike i hapave dhe dinamikave që çuan në Holokaust, përfshirë rolin e akterëve të ndryshëm; përmes kësaj, njohja e kuptimit dhe vlerave të përgjegjësisë qytetare.

Porosia kryesore:

Shumë akterë të ndryshëm patën rol në lejimin (promovimin, ose vetëm mos-kundërshtimin) e ngritjes së nazistëve dhe të Holokaustit. Pavarësisht statusit tonë (punësimi, gjendja ekonomike, prejardhja shoqërore), të gjithë kemi përgjegjësi qytetare. Zgjedhjet dhe vendimet tona kanë ndikim në shoqëritë ku jetojmë. Qytetarët aktivë dhe të vetëdijshëm luajnë rol vendimtar në mbrojtjen e vlerave demokratike.

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit nënvizojnë dhe shqyrtojnë hapat e zhvillimit të Holokaustit. Pjesët a. dhe c. në diskutim plenar. Për pjesën b., nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë – shih udhëzimet më poshtë).

Në këtë njësi mësimore, pamë se si u zhvilluan nazizmi dhe Holokausti. Bazuar në atë çfarë ke mësuar, diskuto pyetjet si në vijim

- Për diskutim plenar: Cilat elemente çuan drejt fuqisë së nazistëve dhe Holokaustit? Nënvido pikat kryesore kthyesë, duke i vendosur në një linjë kohore (nga 1933 deri 1945). Kush ishin akterët kryesorë të përfshirë? Krijë një listë.
- Nxënësit ndahen në 4 grupe (sa më shumë), ku secili grup fokusohet në akterë të ndryshëm:
 - Grupi 1: cili ishte pozicionimi dhe roli i politikanëve gjermanë?
 - Grupi 2: cili ishte pozicionimi dhe roli i qeverive të huaja?
 - Grupi 3: cili ishte pozicionimi dhe roli i qytetarëve gjermanë?
 - Grupi 4: cili ishte pozicionimi dhe roli i hebrenjve në Gjermani dhe në Evropë?
- Diskutim plenar: Bazuar në diskutimet deri tash (pikat a. dhe b.), në cilën fazë do të mund të ndalohej Holokausti? Si? Nga kush?

MATERIALI E KOHA

Nuk nevojitet material

45 min

a: 15 min b: 15 min c: 15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: XII c: XII

6

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Të kuptuarit e domethënies së Holokaustit si shkelje masive e të drejtave të njeriut dhe si gjenocid, dhe krahasimi i tij me ngjarje tjera (në histori dhe në kohët e sotme);

Zbulimi i Kombeve të Bashkuara dhe i UDHR (DUDNJ) si reagim gjithë-botëror ndaj Holokaustit dhe si vullnet për të siguruar mos-përsëritjen.

Porosia kryesore:

Përkundër definicioneve të ndryshme që i janë dhënë kësaj shprehje, Holokausti është dënuar përgjithësisht si shkelje e rëndë dhe sistematike e të drejtave të njeriut dhe është njohur si gjenocid. Të drejtat e njeriut, siç janë të definuara e të mbrojtura nga DUDNJ, janë universale, dhe nuk mund të shkelen nga asnjë sistem politik.

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut:

Anglisht: <https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/index.html>

Shqip: <https://www.ohchr.org/en/udhr/pages/Language.aspx?LangID=aln>

Serbisht: <https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Pages/Language.aspx?LangID=src3>

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë). Secilit grup i ofrohen dy definicionet për Holokaustin. Në fund të pjesës c. (ose në fund të secilës pjesë), secili grup prezanton përgjigjet e veta në diskutim plenar (nëse premton koha).

Bazuar në definicionet e ofruara dhe atë çfarë keni mësuar, diskutoni pyetjet si në vijim:

- Shih definicionet e "Holokaustit": Cilat janë elementet kryesore që e definojnë Holokaustin? A mund të identifikosh ndonjë dallim në këto dy qasje?
- Hulumto lidhur me Deklaratën Univerzale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ): kur u aprovua ajo? Nga kush? Pse ishte posaçërisht e rëndësishme në atë moment? Çfarë rëndësie ka ajo sot?
- Holokausti është definuar si "gjenocid": Për cilat gjenocide tjera ke njohuri? Kush e definon se cilat keqbërje kualifikohen të përshkruhen si "gjenocid"? Çfarë lidhur me Holokaustin është e veçantë dhe çfarë është e përbashkët me ato ngjarje?

MATERIALI E KOHA

SHTOJCA 5: Definicionet e Holokaustit (një kopje për secilin grup); lidhje në internet për hulumtim online (ose kopje e DUDNJ, artikuj të zgjedhur nga mësimdhënësi)

35-40 min a: 10 min b: 15 min c: 10-15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: XII dhe XII c: XII

SHTOJCË 1:

Ligjet e Nurembergut, Ligji për mbrojtjen e gjakut gjerman dhe nderit gjerman, 1935

Të prekur nga të kuptuarit se pastërtia e gjakut gjerman është kushti themelor për vazhdimin e ekzistencës së popullit gjerman, dhe të frymëzuar me vendosmërinë e paluhatur për të siguruar ekzistencën e kombit gjerman për të gjitha kohët, Reichstag (Parlamenti) unanimisht aprovoi ligjin si vijon, me të cilin shpallet se:

Neni 1

1. Martesat në mes të hebrenjve dhe subjekteve të shtetit të Gjermanisë ose në lidhje gjaku me ta, janë të ndaluara. Martesat që lidhen përkundër kësaj janë të pavlefshme, edhe nëse martesa bëhet jashtë shtetit, për të anashkaluar këtë ligj.
2. Procedurat e anulimit (të martesës) mund të nisen vetëm nga prokurori i shtetit.

Neni 2

Marrëdhëniet jashtëmartesore në mes të hebrenjve dhe subjekteve të shtetit gjerman ose në lidhje gjaku me ta janë të ndaluara.

Neni 3

Hebrenjtë nuk guxojnë të punësojnë në shtëpitë e tyre qytetaret femra të Gjermanisë ose që janë në lidhje gjaku me ta, e që janë nën moshën 45 vjeçare.

Neni 4

Hebrenjtë janë të ndaluar të valvojnë flamurin kombëtar ose atë të Rajhut, apo të shfaqin ngjyrat e Rajhut. Ata janë, në anën tjetër, të lejuar të shfaqin ngjyrat hebreje. Ushtrimi i kësaj të drejte është i mbrojtur nga shteti.

Neni 5

Secili person që thyen ndalesën nën Nenin 1 do të dënohet me burg me punë të rëndë.
Një burrë që thyen ndalesat nën Nenin 2 do të dënohet me burgim ose burg me punë të rëndë.
Secili person që thyen ndalesat nën Nenin 3 ose 4 do të dënohet me burg me punë të rëndë për kohë prej një viti dhe me gjobë, ose me një tërësi ose tërësi të katër dënimeve.

SHTOJCË 2:

Kristallnacht (9-10 nëntor 1938)



Gjermanët kalojnë pranë një vitrine të thyer dyqani të një biznesi me pronar hebre, të shkatërruar gjatë Kristallnacht

Burimi: <https://collections.ushmm.org/search/catalog/pa16792>



Një burrë vrojton dëmin në dyqanin e produkteve nga lëkura në Lichtenstein, pas pogromit të Kristallnacht

Burimi: <https://collections.ushmm.org/search/catalog/pa6191>

Letër shkruar nga Arnold (Aharon) Rosenfeld nga Viena, djalit të tij, disa ditë pas Kristallnacht:

Sinagoga u sulmua, të gjitha dritaret u thyen, stolet u shembën, perджа e Arkës u shqye në copa dhe dorëshkrimet e Torah-s (Tevratit) u hodhën jashtë. Gjithë çfarë kishte brenda në sinagogë u shkatërrua, dorëshkrimet e Tevratit u hodhën në dysHEME dhe u shqyen dhe tri dorëshkrime u morën, bashkë me Arkën. Pllakat e zeza përkujtimore u bënë copë (...) Gjatë natës, deri në ora një, mund të dëgjoheshin britmat e njerëzve që po sulmoheshin. Mbrëmë vizituam Eugen Hess dhe rrugica dukej sikur të kishte rënë borë. Gjithçka ishte mbuluar me pendla që ishin hedhur nga banesat. (...) A ka ndonjë mundësi që Willson (ambasadori i SHBA-ve në Gjermani) do të përfshihet kur të dëgjojë çfarë ka ndodhur? Si mund të shpresojmë për ndihmë nëse kjo nuk bëhet publike?

(Burimi: <https://www.yadvashem.org/gathering-fragments/stories/clouds-of-war/kristallnacht-letter.html>)

SHTOJCË 3:

Foto nga e kaluara dhe e tashmja
Kampi i përqendrimit dhe shfarosjes Sajmishte, Beograd, Serbi (Jugosllavi)



Një grup të burgosurish në kampin e përqendrimit

Burimi: https://photos.yadvashem.org/photo-details.html?language=en&item_id=98979&ind=37



Hyrja kryesore e kampit dhe kulla vroituese

Burimi: <https://www.holokaust.arhiv-beograda.org/concentration-camp-at-sajmiste/?lang=en>



Vendndodhja e kampit të Sajmishtes sot / Përmendorja e kampit të përqendrimit në Sajmishte

Burimi: <https://www.kathmanduandbeyond.com/visiting-site-sajmiste-concentration-camp-new-belgrade/>



Geto hebreje, Varshavë, Poloni



Një grua dhe fëmijët e saj në rrugë në Geton e Varshavës, shtator 1941

Burimi: <https://collections.ushmm.org/search/catalog/pa2380>



Muri që ndanë geton nga zona ariane, maj 1941

Burimi: https://photos.yadvashem.org/photo-details.html?language=en&item_id=100882&ind=14




Fragment nga ish-Geto e Varshavës në rrugën Sienna, shkurt 2018

Burimi: <https://www.timesofisrael.com/parts-of-warsaw-ghetto-wall-to-become-historic-monuments/>

SHTOJCË 4:

Letër nga Legata Mbretërore e Shqipërisë në Berlin dërguar z. Ekrem Libohovës, Ministër i Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Shqipërisë, 16 janar, 1939



Z. Minister,

Kam nderin t'i parashtroj ketu-shydhun asaj P.T. Ministrije lutjen qe ka paraqitur z. Dr. Kurt Haberlandi, banues ne Berlin. Zotnia ne fjale asht 43 vjeç dhe izraelit. Ka pas mare pjese ne luften botnore dhe ka merituar dy dekorata luftarake. Ne kohen kur ka qene i ndijeri Hindenburgu Kryetari i Republikes Gjermane paska sherbyer si sekretar i Tij privat.

Si do te kuptohet nga shkresa e tij, Z.K. Heberlandi deshiron te vije ne Shqiperie dhe te krijojë nje shoqeni shqiptare me kapitale te huaja. Natyrisht kete e nuk ben per dashurine qe ka per kombin t'one, por mbassi esht izraelit dhe ketu ne Gjermani nuk do te mundi te punoje lirisht, ka menduar qe te vije e te punoje ne Shqiperie. Nyrja e nji kapitalit kaq se rëndesie, mendoj se do te jete nji fitim per mekambjen t'one ekonomike. Si pata nderin te flitsha edhe verbalisht kur isha per heren e fundit ne Tirane, ne gofte se nuk ka ndonji ndalin, J'u lutem te kenia miresine e te urdheroni lejimin e tij per me ardhne ne Shqiperie.

...Pozita e çifuteve tue qene se esht e pa stabilizuar dhe per çdo çast mund te pesojne shtrengime e ndalime te paprituna, J'u lutem te keni miresine e te urdheroni lejimin e tij per me ardhne ne Shqiperie. Mbasi ligjet e rea gjermane ardhjen e tij ne Shqiperie mund t'a quajne si emigrim dhe t'i zaptojne pasurine e Tij...

... J'u lutem te keni miresine e te urdheroni lejimin e tij per me ardhne ne Shqiperie. Mbasi ligjet e rea gjermane ardhjen e tij ne Shqiperie mund t'a quajne si emigrim dhe t'i zaptojne pasurine e Tij...

SHTOJCË 5:

Definicionet/përkufizimet e “Holokaustit”

Definicioni / Përkufizimi 1: Muzeu i Përkujtimit të Holokaustit i Shteteve të Bashkuara

Holokausti ishte një ndjekje dhe vrasje sistematike, e përkrahur nga shteti, e gjashtë milion hebrenjëve nga regjimi nazist dhe aleatët e bashkëpunëtorët e tyre. Nazistët erdhën në fuqi në Gjermani në janar 1933. Ata besonin se gjermanët i takojnë një race që është më “superiore” ndaj të gjitha të tjerave. Ata pohonin se hebrenjtë i takonin një race që ishte “e ulët” dhe ishin kërcënim për të ashtuquajturën komunitetin e racës gjermane.

(Burimi: <https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/article/introduction-to-the-holocaust>)

Definicioni / Përkufizimi 2: Yad Vashem

Holokausti ishte një gjenocid i pashembullt, total dhe sistematik, i kryer nga Gjermania naziste dhe bashkëpunëtorët e saj, me qëllim të shfarosjes së popullit hebre. Motivimi parësor ishte ideologjia naziste, raciste anti-semitike. Në mes të viteve 1933 dhe 1941 Gjermania naziste ndoqi një politikë që i zhveshi hebrenjtë nga të drejtat dhe pronat e tyre, përcjellë me shenjësimin dhe grumbullimin e popullatës hebreje. Kjo politikë morri përkrahje të gjerë në Gjermani dhe në pjesën më të madhe të Evropës së okupuar. Në vitin 1941, pas pushtimit të Bashkimit Sovjetik, nazistët dhe bashkëpunëtorët e tyre nisën vrasjen masive dhe sistematike të hebrenjëve. Deri në 1945, afër gjashtë milionë hebrenj u vranë.

(Burimi: <https://www.yadvashem.org/holocaust/about.html#learnmore>)

Kapitulli 3

Kosova dhe Holokausti

Holokausti u shfaq në Ballkan pas pushtimit, fillimisht nga forcat italiane e më pas nga ato gjermane. U krijuan shtete kukulla, dhe u instaluan qeveri kolaboracioniste. Në shumicën e territoreve që kontrolloheshin drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga Boshti, hebrenjtë diskriminoheshin, dhe u hapën kampe të përqendrimit. Përpos hebrenjve, njerëzit si sllavët, romët ose grupet tjera që nazistët i shihnin, e i konsideronin si raca të ulëta u përdoqën dhe u vranë. Nën pushtimin italian, ligjet raciste që u shpallën nuk u zbatuan plotësisht. Kjo rezultoi në atë që hebrenjtë nga Ballkani dhe Evropa të iknin në Shqipëri, përmes Kosovës. Përse ishte Shqipëria një parajsë e sigurt për hebrenjtë? Si ishte situata në Kosovë?

Politika shqiptare ndaj hebrenjve

Shtypi njoftoi për dhënien e shtetësisë dhe pasaportës shqiptare hebrenjve që kërkonin azil profesional ose politik në Shqipëri. Ky fakt u vërtetua nga shtypi evropian i kohës. Në 10 qershor 1935, gazeta ditore "Momenti", botuar nga komuniteti hebre në Poloni (...) deklaronte se Qeveria e Shqipërisë mori një vendim të tillë në një mbledhje të veçantë, dhe i thirri të gjithë hebrenjtë nga Çekosllovakia dhe Gjermania ta shohin këtë shtet si shpëtimin e tyre (...). Ky lajm u shpërnda te shtypi i huaj edhe nga konsulli shqiptar në Londër. Në komentet e tij për "Agjencinë telegrafike hebreje" dhe "Kronikat hebreje" ai prezantohet si zëdhënës i qeverisë. Deklarimi publik i konsullit shqiptar u publikuar edhe në publikimet tjera të komunitetit hebre, duke siguruar që Shqipëria ishte një shtet i besueshëm që po ofronte sukses për asetet e hebrenjve.

Pushtimi i Ballkanit Perëndimor

Në prill 1939, Italia pushtoi Shqipërinë dhe mbreti Zog iku në ekzil. Nga perspektiva ushtarake, Shqipëria ishte një vend me rëndësi strategjike për Italinë, sepse prej aty mund të kontrollonte të gjithë Detin Adriatik. Shqipëria i shërbeu Italisë si urë për të kaluar në Ballkan. Nga perspektiva ekonomike, Shqipëria posedonte resurse vitale natyrore, posaçërisht naftë dhe krom, që ishin me rëndësi për industrinë e luftës.

Pushtimi italian i Greqisë u nis nga Shqipëria në tetor 1940, por shpejt u kundërshtua nga ushtria greke, përkrahur nga Britania e Madhe. Derisa lufta po thellohej, Hitleri vendosi t'i shkonte në ndihmë ushtrisë italiane pasi që frikësohej se përkrahja britaneze për forcat greke mund të bëhej kërcënim për avancimin e Gjermanisë në Evropën Lindore. Në prill 1941, forcat gjermane të përkrahura nga italianët dhe bullgarët pushtuan Jugosllavinë, dhe ajo sikurse Greqia iu dorëzuan forcave të Boshtit. Forcat e Boshtit i ndanë territoret e pushtuara mes vete: pjesa më e madhe e Kroacisë dhe Bosnjës e Hercegovinës u bënë "Shteti i pavarur i Kroacisë", një shtet kukull i forcave të Boshtit; pjesa më e madhe e Serbisë ishte okupuar nga gjermanët: pjesa më e madhe e Maqedonisë iu bashkëngjiti Bullgarisë dhe pjesa më e madhe e Malit të Zi ra nën okupimin italian.

Ndarja e Kosovës në mes të Gjermanisë, Italisë dhe Bullgarisë

Pas disfatës së Jugosllavisë, pjesë të mëdha të Kosovës dhe disa të Maqedonisë u përfshinë në Shqipëri, nën kontrollin italian.

Kjo ndodhi për shkak se gjermanët dhe italianët kishin qenë dëshmitarë të dhunës ndëretnike në Kosovë dhe shpresonin ta përdorin atë në dobi të veten. Duke favorizuar shqiptarët e Kosovës, në veçanti gjermanët shpresonin të merrnin përkrahjen e tyre në shtypjen e serbëve të Kosovës. Gjermanët besonin se nxitja e dhunës së mëtejshme ndëretnike do shërbente si mënyrë që do të mbante popullatën lokale "të zënë" me njëri-tjetrin në vend që të ngriheshin kundër okupatorëve të tyre.

Meqenëse gjermanët kishin interes ekonomik në zonën përreth Mitrovicës, për shkak të burimeve minerare që nevojiteshin për industrinë e armatimit, kjo pjesë e Kosovës iu shtua Serbisë, e cila ishte nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Rajhut të Tretë. Më pas, deri në 40-50% e të gjithë plumbit të përdorur nga industria gjermane e luftës u sigurua nga Trepça. Tutje, rajoni rreth Kaçanikut iu dha Bullgarisë. Si përmbledhje, ndarja e Kosovës tregon se forcat e Boshtit vepronin për interesat e tyre strategjike dhe ekonomike, e jo në dobi të shqiptarëve.

Hebrenjtë në Kosovë dhe Shqipëri nën okupimin italian

Gjatë okupimit italian të Shqipërisë dhe Kosovës në mes të viteve 1939 dhe 1943, italianët nuk ishin drejtpërdrejtë armiqësor ndaj hebrenjve, por provuan të bëjnë presion mbi qeverinë shqiptare që t'i regjistronin bile edhe t'i dëbonte hebrenjtë. Shqipëria kishte një komunitet të vogël hebre, numri i të cilëve u rrit pas ftesës nga mbreti Zog në mesin e viteve '30-ta për të hapur kufijtë e shtetit të tij për hebrenjtë që po përballeshin me persekutim nga nazistët. Mijëra hebrenj nga vende të ndryshme të Evropës, përfshirë Jugosllavinë dhe Greqinë, ikën në Shqipëri. Qeveria shqiptare argumentonte se ata hebrenj që kishin hyrë në Shqipëri si turistë ishin duke pritur lejen për të lëvizur në SHBA ose që nuk mund të ktheheshin në shtetet e origjinës së tyre, që ishin nën okupimin gjerman, pasi që do të persekutoheshin. Italianët nuk e ndoqën tutje këtë politikë, por u pajtuan që këta hebrenj të transferoheshin në Berat, një qytet shqiptar ku historikisht kishte një komunitet hebre. Besohet se shumica e hebrenjve që jetonin në Kosovë u detyruan të shpërnguleheshin në Shqipëri. Ky transferim u përkrah nga qeveria shqiptare dhe nga kryetari i komunës së Prishtinës, që ishte një shqiptar i Kosovës. Shumica prej tyre u vendosën në Berat: 94 familje dhe 87 individë.

Hebrenjtë në Kosovë dhe Shqipëri nën okupimin gjerman

Gjendja e hebrenjve nën okupimin nazist në Kosovë ishte shumë më e keqe. Hebrenjtë ndiqeshin e arrestoheshin dhe detyroheshin në punë ose dërgoheshin në kampe të përqendrimit, përfshirë kampin Bergen-Belsen, ku shumica prej tyre vdiqën. Për shembull, në gusht 1941, të gjithë burrat hebre dhe në muajin shkurt edhe gratë dhe fëmijët në Mitrovicë u arrestuan. Në mars 1942, të gjithë hebrenjtë e dënuar u dërguan në Sajmishte, një kamp përqendrimi afër Beogradit. Nga 113 hebrenj sa jetonin në Mitrovicë, vetëm 25 mbijetuan pasi mundën të iknin përmes zonës së okupuar italiane.

Në shtator 1943, Italia iu dorëzua forcave Aleate. Forcat gjermane atëherë okupuan territoret e Kosovës dhe Shqipërisë, të cilat më herët i mbanin italianët. Arritja e gjermanëve shkaktoi frikë në mesin e hebrenjve pasi që frikësoheshin se mund të persekutohen siç kishte ndodhur me hebrenjtë në Mitrovicë nën pushtimin gjerman. Me qëllim që të fshehen nga gjermanët, disa u zhvendosën në zona më të sigurta, siç ishin malet e Shqipërisë. Këto frika u bënë realitet pasi gjermanët i shtuan përpjekjet për të gjetur dhe dëbuar hebrenjtë. Në fillim të vitit 1944, një kamp i vogël



Dy tanke avancojnë në Durrës (Shqipëri) përcjellë nga trupat italiane, 7 prill 1939

Burimi: <https://patrimonio.archivioluce.com/luce-web/detail/IL0010035772/12/due-piccoli-carri-armati-avanzano-strada-durazzo-seguiti-soldati-italiani.html>

Fjala e dhënë - Besa


Marco Menachem, një hebre i shpëtuar thotë:

"Ka një fjalë në shqip, 'besa', që nënkupton fjalën e nderit. Nuk ka asgjë më të shenjtë për një shqiptar se sa besa e tij. Kur ai e jep besën, ai do të kalojë nëpër ferr e zjarr, por do ta mbajë fjalën e nderit. Besa ishte çelësi që i shpëtoi hebrenjtë."

Burimi: <https://www.yadvashem.org/righteous/reBurimis/rescue-of-jews-in-albania-through-yadvashem-files.html>

përqendrimi/mbajtjeje u hap në Prishtinë, ku mbaheshin të burgosurit politikë, komunistët, si edhe hebrenj. Disa nga këta të burgosur u dëbuan në kampe tjera, përfshirë kampin Bergen-Belsen.

Përpos hebrenjve, edhe romët ishin masakruar nga gjermanët për shkak të etnisë së tyre. Deri më sot, është e paqartë se sa romë janë vrarë ose dëbuar nga Kosova; Në Serbi, u vranë disa mijëra. Edhe serbët konsideroheshin si racë më e ulët, sipas ideologjisë naziste, të klasifikuar si sllavë. Prandaj, okupimi gjerman i Serbisë ishte i ashpër (p.sh., për t'u hakmarrë ndaj sulmeve të partizanëve mbi ushtarët gjermanë, mbi 2000 civilë u masakruan nga ushtria gjermane, si në Kralejë edhe në Kragujevc).



Irene Grünbaum

lindur dhe rritur në Gjermani, më vonë e martuar për një hebre serb dhe e zhvendosur në Beograd. Në vitin 1941, pas okupimit nazist të Jugosllavisë dhe implementimit të politikave të saja anti-semitike, ajo iku në Maqedoni, e më pas në Shqipëri ku i kaloi katër vitet e ardhshme të jetës së saj. Në autobiografinë e saj, ajo e kujton jetën e vet dhe përvojat e të ikurve hebrenj në Shqipëri.

Gjermanët tashmë e kanë kapur mirë Shqipërinë (pas korrikut 1943). Çdo ditë urdhra dhe dekrete të reja vijnë nga pozitat "e larta", [...]Përafërsisht treqind hebrenj që ishin ende në Shqipëri, po kërkonin mbrojtje dhe vend për t'u fshehur. Pothuajse pa përjashtim, popullata e Shqipërisë, pavarësisht statusit shoqëror ose bindjeve politike, u dha atyre ndihmë. Ndjenja e tyre për drejtësi nuk ju lejonte të refuzojnë të drejtën e azilit për burrat, gratë dhe fëmijët e pafajshëm. Të gjithë kishim shoqëri në Shqipëri: dikush gjeti vend të fshehej në shtëpinë e këpucëtarit, tjetri te mësuesi, tjetri te ministri...

Burimi: Irene Grünbaum, 1996, "Escape through the Balkans: The Autobiography of Irene Grünbaum", University of Nebraska Press, p. 99



Gavra Mandil

lindi në Beograd. Pas okupimit gjerman në vitin 1941, familja e tij, që kishte gjetur strehim në Prishtinë, u burgosën, bashkë me hebrenjtë tjerë, në burgun e komunës. Anëtarët e saj më pas u dëgdisën në Shqipëri nga italianët. Gjatë vjeshtës së vitit 1943, pas pushtimit gjerman të Shqipërisë, ata u detyruan të fsheheshin. Refik Veseli, një shqiptar mysliman, i cili më vonë do të bëhej i pari i Drejtë Mes Kombeve në Shqipëri, i mbrojti dhe i fshehi ata. Në 1948, Gavra dhe familja e tij emigruan në Izrael dhe u vendosën në Haifa.

Kam lindur në Beograd, Jugosllavi, në 1936. Kur gjermanët depërtuan, unë isha katër vjet e gjysmë. Babai im refuzoi të regjistronte familjen e vet te gjermanët siç e kërkonte ligji dhe siç vepruan shumë hebrenj të tjerë, dhe me ndihmën e miqve serbë ikën me letra të rreme në jug të Jugosllavisë, në zonën nën kontrollin italian. Shpejt pas kësaj, hebrenjtë u arrestuan dhe u vendosën në burgun e Prishtinës, që pjesërisht u shndërrua në kamp përqendrimi për hebrenj. Babai im, nëna, motra më e re [...] dhe unë ishim një nga njëqind familjet hebreje që ishin burgosur në atë kamp. Gjatë kohës sa qëndruam atje – për gati një vit – grupe të familjeve hebreje dërgoheshin të vriteshin, siç thonin për të zbutur kushtet me mbipulullim të kampit. Në qershor 1942, [...] një grup prej 120 hebrenjve u arratisën në Shqipëri, që gjithashtu ishte nën pushtimin italian. Në Shqipëri, familjet hebreje nga Jugosllavia u shpërndanë në qytete të ndryshme [...] Kështu ne jetuam në mirëqenie relative deri në dorëzimin e Italisë në mes të Luftës së Dytë Botërore në vjeshtë të vitit 1943.

Pastaj gjermanët erdhën në Shqipëri dhe hebrenjtë u dështën të iknin në male, në pyje dhe në fshatrat e izoluara shqiptare. Në ato kohë të vështira, populli shqiptar e shfaqti lavdinë dhe madhështinë e tij të plotë. Nuk kishte asnjë familje hebreje që dështoi të gjejë strehim brenda popullsisë lokale shqiptare, qoftë tek fshatarët e varfër ose tek pronarët e shtëpive të pasura. Asnjë hebre nuk mbeti pa mbrojtjen e shqiptarëve. Në shumë raste, si në rastin tonë, strehimi i hebrenjve përfshinte rrezikun e vdekjes dhe kërkonte vet-flijim kolosal! [...] Shumica e të mbijetuarve në Shqipëri emigruan në Izrael dhe sot jetojnë aty.

Burimi: Gavra Mandil's letter to Yad Vashem, June 1987 (<https://www.yadvashem.org/righteous/stories/veseli/mandil-letter.html>)

Divizioni SS “Skanderbeg”

Ndërsa gjermanët kërkonin një numër më të madh ushtarësh për të luftuar forcat sovjetike që po përparonin në frontin Lindor, ata krijuan divizione të reja të përbëra nga rekrutë lokalë në vendet e okupuara, për të luftuar nën komandën gjermane, për t'i mbajtur nën kontroll ato territore. Kjo nënkuptonte që forcat e ushtrisë gjermane, që ishin të ushtruara më mirë, mund të zhvendoseshin në frontin Lindor.

Në shkurt të vitit 1944, ministri gjerman i punëve të brendshme dhe kreu i organizatës paraushtarake “Schutzstaffel” (shkurt: “SS”) Heinrich Himmler mori miratimin e drejtpërdrejtë nga Hitleri për krijimin e Divizionit SS “Skanderbeg” në Kosovën dhe Shqipërinë e okupuar. Gjatë rekrutimit të njerëzve vendas, nazistët u përqendruan në Kosovë dhe jo në Shqipëri, për një sërë arsesh: në Kosovë, inatet dhe përleshjet ndëretnik kishin bërë që shumë shqiptarë të Kosovës të ishin të interesuar të armatoseshin dhe të trajnoheshin për t'u përballur me serbët, të cilët i shikonin si pushtues dhe shtypës; Lidhja e Dytë e Prizrenit fillimisht premtoi të përkrahte angazhimet për rekrutim; një pjesë e konsiderueshme e popullsisë mbante qëndrime anti-komuniste; një pjesë e madhe e popullsisë jetonte nga bujqësia, për çka nazistët shpresonin të gjenin rekrutë në mesin e bujqve të fortë e të shëndetshëm, që punonin në ara. Për të joshur më shumë popullatën vendase që t'i bashkohej Divizionit SS, nazistët përdorën emrin e heroit kombëtar Skënderbeut, dhe ushqenin shpresë për një shtet të pavarur shqiptar pas luftës (një premtim të cilin nazistët e bënë vetëm për të fituar mbështetjen e shqiptarëve –por, që nuk është e dokumentuar se ata kishin qëllim ta mbanin atë premtim). Ushtarëve në Divizion iu jepnin rroba të ngrohta, çizme të mira dhe një pagë të vogël, kështu veçanërisht u josh popullata e varfër. Përveç kësaj, shumë nazistë kishin qëndrim pozitiv ndaj shqiptarëve, pasi që i shikonin ata, brenda ideologjisë së tyre raciste, si një popull afëridealeve naziste dhe si vëllezër të luftës në betejën e tyre anti-sllave dhe anti-komuniste. Megjithatë, ky qëndrim pozitiv u zbeh ndërsa lufta do përparonte.

Fillimisht, gjermanët kishin planifikuar të themelonin një formacion me dhjetë deri dymbëdhjetë mijë burra, por numri i të rekrutuarve arriti rreth 6500. Divizioni ishte nën komandën direkte gjermane. Ai u formua me ish të burgosur, shqiptarë të Kosovës që kishin shërbyer në ushtrinë jugosllave, të rekrutuarit nga Divizioni SS boshnjak “Hanxhar” (Hadschar), vullnetarë shqiptarë – posaçërisht nga Kosova – dhe me ish anëtarë të ushtrisë dhe xhandarmërisë në Shqipëri. Entuziazmi fillestar i nazistëve shpejt u shua për shkak të numrit të madh të dezertimeve. Deri në tetor 1944, rreth 3500 ushtarë, më shumë se gjysma e forcave fillestare, kishin dezertuar. Divizioni zyrtarisht u shpërbë në nëntor.



Fotografi propagandistike për të rekrutuar më shumë shqiptarë

Burimi: www.kriegsberichte-archiv.com
Foto: Administrata e SHBA për Arkivat Kombëtare dhe Shënimet (NARA)



Portret grupor i fëmijëve të familjeve të refugjatëve hebrej të burgosur në burgun e Prishtinës, 1942

Burimi: <https://collections.ushmm.org/search/catalog/pa1086708>



Në këmbë, nga e djathta në të majtë: Arslan Rezniqi, Dr. Chaim Abravanel dhe Mustafa Rezniqi, djali i Arslanit; ulur nga e djathta në të majtë: Dr. Reni Levi – Abravanel, Berta Abravanel, gruaja e Arslan Rezniqit, një grua e panjohur dhe foshnja Rahel Levi

Burimi: <https://righteous.yadvashem.org/?search-Type=all&language=en&itemId=6360449&ind=24>

Sipas dokumenteve gjermane, Divizioni SS “Skanderbeg” ishte përgjegjës për ruajtjen e kampit të përqendrimit/mbajtjes në Prishtinë, dhe për arrestimin e disa dhjetra deri disa qindra hebrejve, të cilët u sollën në kamp.

Shpëtimi i hebrejve në Shqipëri dhe Kosovë

Deri në fund të 1944, partizanët dhe forcat aleate i kishin larguar forcat gjermane jashtë Kosovës dhe Shqipërisë. Qeveria kolaboracioniste në Shqipëri u kishte rezistuar kërkesave italiane dhe gjermane lidhur me ndjekjen e hebrejve në vend. Shqipëria ishte një nga të paktat shtetet që kishin ofruar strehim dhe mbrojtje për hebrejtë që vinin nga shtetet tjera evropiane. Besohet se rreth 2000 hebrej u shpëtuan, krahasuar me vetëm rreth 200 hebrej që kishin jetuar në Shqipëri para luftës.

Nuk ishte vetëm qeveria që luajti rol në mbrojtjen e hebrejve. Qindra individë dhe familje hebreje u mbrojtën nga familjet shqiptare, të cilat u ndryshuan emrat dhe veshjet mysafirëve të tyre, në mënyrë që t’i bënin ata të dukeshin nga jashtë si anëtarë të familjes, e si të tillë zakonisht edhe i trajtonin. Sipas tregimeve të shumë të mbijetuarve hebrej, mikpritësit e tyre e ndërlidhnin mbrojtjen e hebrejve me institucionin e “Besës”, (fjalës së dhënë) nga kodi i nderit dhe mikpritjes shqiptare, e gjetur nën shprehjen “Shtëpia i takon Zotit dhe mysafirit”.

Në Kosovë, një rrjet njerëzish organizonin strehimin dhe transportin për në Shqipëri, si dhe strehimin te familjet atje. Mes të tjerëve, pjesë e këtij rrjeti ishte edhe familja Rezniqi, kryesuar nga Arslan Mustafa Rezniqi, i cili shpëtoi mbi 40 familje hebreje. Familjet e Hasan Remë Xërxës, Halim Spahisë, Arif Aliçkajt, Spiro Litos, Hysen Prishtinës, Prenk Ulit ishin gjithashtu në mesin e atyre që fshehën dhe mbrojtën hebrejtë.

Jeta pas Holokaustit

Pas përfundimit të luftës, shumica e hebrejve që arritën të mbijetonin në Kosovë dhe Shqipëri, u larguan. Shumë u zhvendosën në Palestinë dhe në shtetin e sapo-formuar të Izraelit, të tjerët u kthyen prej nga fillimisht kishin ardhur ose filluan një jetë të re diku tjetër (p.sh. SHBA dhe Brazil).

Një numër i vogël i hebrejve mbetën në Kosovë, kryesisht në Prizren. Sot, komuniteti hebre në Kosovë ka rreth 10% të madhësisë së tij të para luftës. Numri i saktë i hebrejve që jetojnë në Kosovë është i panjohur: sipas burimeve të ndryshme, disa dhjetra familje.

Disa relikte hebreje i shpëtuan okupimit gjerman, siç janë varrezat hebreje si edhe lokacioni i një ish-shkolle hebraike në Prishtinë. Vende të tjera, të tilla si sinagoga, përkujtohen vetëm me një monument para ndërtesës së qeverisë, pasi që jeta hebreje në Kosovë thuhet se plotësisht u shkatërrua gjatë okupimit nazist dhe regjimit pasues socialist.

Në Shqipëri, kujtesa dhe të dhënat e hebrenjve të shpëtuar nga shqiptarët ishte ndrydhur dhe u fshehur nga frika e mbjellur nga politikat e regjimit të Enver Hoxhës. Kjo do të thotë se shumë nga historia dhe njohuritë janë humbur.

Të Drejtës Mes Kombeve

Yad Vashem (Qendra Botërore e Përkujtimit të Holokausti), një muze dhe institucion kërkimor dhe arsimor në Izrael, është themeluar për të përjetësuar kujtimin e gjashtë milionë hebrenjve, viktimat të Holokaustit. Një prej roleve kryesore të Yad Vashem është të përçojë mirënjohjen e Izraelit dhe të popullit hebre për johebrenjtë që rrezikuan jetët e tyre për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Holokaustit, duke u dhënë këtyre njerëzve titullin e “Të Drejtës Mes Kombeve”. Kjo mirënjohje thekson parimin që secili person është përgjegjës për veprat e tij a të saj. Ky program ka për qëllim të gjejë në mesin e popujve të autorëve të krimeve, bashkëpunëtorëve dhe atyre që nuk reagojnë, individë që kundërshtuan prirjen e përgjithshme dhe ndihmuan hebrenjtë e përndjekur. Deri më tash, shtatëdhjetë e pesë individë ose familjeve shqiptare ju është dhënë titulli “Të Drejtës Mes Kombeve”. Nga Kosova, këtë titull e bartin 7 familje ose individë, nga komunitetet shqiptare, serbe dhe kroate. Gjithashtu, ky titull i është dhënë edhe Hajrija Imeri-Mihaliq-it, e vetmja rome në botë që e mbanë këtë titull.

Nora Sheko në letrën e saj për Departamentin e të Drejtës, 21 nëntor 1992

“Më vjen keq të them se nuk i kam më letrat dhe adresat e tyre, sepse gjatë 45 viteve ne kemi vuajtur shumë nën regjimin komunist, prandaj i kemi futur në dhe të gjitha letrat që kishin ardhur nga shtetet tjera, për të cilat gjithsesi do të na llogarisnin si spiun dhe propagandues, e kjo nënkuptonte së paku dhjetë vite burg. Burri im ishte tri vite në burg vetëm pse ishim shumë të pasur.”

Burimi: <https://www.yadvashem.org/righteous/reBurimis/rescue-of-jews-in-albania-through-yad-vashem-files.html>

Arsllan Mustafa Reznici

Gjatë luftës, Dr. Chaim Abravanel, një fizikant hebre nga Shkupi, Maqedonia, në ushtrinë Jugosllave, u vendos në Kosovë. Kur shpërtheu një epidemi e tifosë, Dr. Abravanel i trajtoi të sëmurët, përfshirë familjen shqiptare Reznici (...). Në prill 1941, gjatë pushtimit gjerman të Jugosllavisë, njësisë ushtarake e Abravanelit u burgos nga gjermanët. Kur Rezniciqët dëgjuan që mjeku ishte në kamp, ata filluan të kërkonin mënyra se si t'a ndihmonin. Arsllani dhe djali i tij veshën rroba tradicionale shqiptare dhe u përvdihën brenda në kamp. Ata arritën në pjesën ku mbaheshin të burgosurit hebrenj, e gjetën Dr. Abravanelin dhe i kërkuan që edhe ai të vishte një palë rroba shqiptare që i kishin sjellë me vete. Ata e larguan atë nga kampi dhe e dërguan në shtëpinë e tyre ku ai qëndroi deri sa mundi të kthehet te familja e tij në Shkup. Rezniciqët e shoqëruan në udhëtimin e tij për në shtëpi dhe u siguruan që ishte i sigurtë. Chaim Abravanel, gruaja e tij Bertha dhe fëmijët e tyre arritën t'i shpëtojnë dëbimeve nga Maqedonia dhe mbijetuan Holokaustin, por që të dy humbën prindërit e tyre, gjashtë vëllezër e motra si edhe familjet e tyre. Pas luftës, Dr. Abravanel u bë drejtor i spitalit në Manastir, Maqedoni. Mbesa e tij Rachel (...) i kërkoi Yad Vashem ta njohë shpëtimtarin e gjyshit të saj, Arsllan Mustafa Rezniciqin si një “I Drejtës Mes Kombeve”, që iu dha në 12 shkurt 2008.

Burimi: <https://righteous.yadvashem.org/?searchType=all&language=en&itemId=6360449&ind=24>

Hajrija Imeri-Mihaliqi

Në kohën e pushtimit gjerman të Jugosllavisë, në prill 1941, familja e të voglës Ester (Levy), e lindur një vit më herët, jetonte në Prishtinë. Me frikë nga regjimi pro-nazist (...), që kishte marrë kontrollin mbi këtë rajon, prindërit e Esterit ikën në male që të bashkohen me partizanët, duke e lënë vajzën e vogël nën kujdesin e gjyshes së saj. Një vit më herët, çifti Baruch (prindërit e Ester) kishin punësuar një dado, një cigane* të quajtur Hajrija Imeri, që jetonte në një fshat afër (...). Shpejt pas kësaj, Hajrija kuptoi që Ester dhe gjyshja e saj ishin marrë nga autoritetet dhe ishin dërguar në një kamp pune. Ajo shpejtoi atje dhe u takua me gjyshen e frikësuar, e cila e luti që ta marrë fëmijën. "Të lutem ruaje dhe kujdesu për të si për fëmijët tu. Nëse familja e saj kthehen, ata do ta marrin me vete, e nëse jo, mbaje si vajzën tënde." Duke u larguar shpejt nga kampi (në Mitrovicë), Hajrija e mori vajzën njëvjeçare në fshatin e fisit të saj, dhe e bëri bashkë me pesë fëmijët e saj. Ajo i dha fëmijës emër të ri – Miradie, dhe e trajtonte me kujdes të veçantë. Gjatë netëve, familja Imeri shtrinte kashtë në dysheme, dhe të gjithë shtriheshin për të fjetur, derisa Miradia futej në mesin e fëmijëvetë tjerë – gjithmonë në mes, për siguri shtesë. (...)

Pas luftës, Ester u kthye te nëna e saj dhe familja e saj u zhvendos në Izrael. Më pas, përmes Yad Vashem, Ester aplikoi që Hajrija të shpërblehet me titullin e "Të Drejtëve Mes Kombeve", e vetmja rome e nderuar me këtë çmim.

Burimi: Mordecai Paldiel, 2000, Shpëtimi i hebregjeve: Burrat dhe gratë që sfiduan Zgjidhjen Finale

[*shprehja "cigan/e" përdoret për t'ju referuar komunitetit rom. Sot, ajo ka konotacion negativ (stereotip): prandaj nuk do të duhej të përdoret]

Pero Jovanoviq

Në vjeshtën e vitit 1941, shumë refugjatë hebrenj ngecënnë Prizren, Kosovë, kur fluturimi i tyre për në Shqipëri u bllokua. Në mesin e tyre ishte edhe çifti hebre, Eugen dhe Else Hochberg, vajza e tyre trevjeçare Miriam, dhe mbesa, Adela Georgenberger. Eugeni, një inxhinier, u njoftua me Milan Jovanoviqin, i cili ju ofroi një dhomë me qira në shtëpinë e tij. Dy familjet jetuan bashkë dhe ndanin përgjegjësitë e shtëpisë. Kur patrullat gjermane iu afruan këtij rajoni, Jovanoviqët i fshehën hebrenjtë në vende të ndryshme në shtëpinë e tyre. Megjithatë, (...) autoritetet u lajmëruan për ta. Në fillim të vitit 1944, gjermanët arrestuan çiftin Hochberg dhe Adelën, dhe i dëbuan ata në një kamp përqendrimi. Miriam mbeti mbrapa me Jovanoviqët. Djali 17 vjeçar i Jovanoviqëve, Pero, u bë shoku më i afërt i Miriamit. Miriam u sëmur nga paraliza e fëmijëve, dhe kishte nevojë për trajtim të vazhdueshëm mjekësor. Pero u kujdes për të për më se një vit, deri sa ajo u shërua. Çdo ditë, Pero e bartte Miriam në krahë për trajtim në spitalin që ishte në skajin tjetër të qytetit. Kur lufta përfundoi, çifti Hochberg u kthyen në Prizren për të marrë vajzën e tyre dhe për të falënderuar Jovanoviqët për vendosmërinë e tyre në kujdesin ndaj Miriam. Miriam Hochberg (më pas Werzberger) migroi në Izrael dhe krijoi familje. Ajo i mbajti kontaktet me mikëpritësit e saj të kohës së luftës.

Më 8 shtator, 1993, Yad Vashem e njohu Pero Jovanoviq-in si të Drejtë Mes Kombeve.

Burimi: https://righteous.yadvashem.org/?search=kosovo&searchType=righteous_only&language=en&itemId=4015481&ind=8

Kapitulli 3: USHTRIME PËR NXËNËSIT

1

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Shqyrtim kritik dhe krahasim i situatave në Shqipëri dhe Kosovë gjatë okupimit italian dhe gjerman.

Porosia kryesore:

Në shumicën e territoreve që ishin drejtpërdrejtë ose tërthorazi të kontrolluara nga Boshti, hebrenjtë diskriminoheshin. Megjithatë, gjendja e hebrenjve në Shqipëri, nën okupimin italian, ishte më e favorshme se ajo e hebrenjve në Kosovë, nën sundimin gjerman. Për shkak të shumë faktorëve (përfshirë tensionet ndëretnike prej më herët), gjermanët gjetën “tokë pjellore” në Kosovë për të themeluar një Divizion SS lokal.

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë). Në fund të pjesës b. (ose në fund të secilës pjesë) secili grup prezanton përgjigjet e veta në diskutim plenar.

Bazuar në njohuritë e fituara nga ky mësim, nxënësit krahasojnë situatën në Shqipëri dhe Kosovë:

- Përmbledhi dallimet në mes të situatave në Kosovë dhe në Shqipëri: në çfarë mënyre këto situata ishin të ndryshme për hebrenjtë? Pse?
- Fokusohu në Divizionin SS Skanderbeg: Pse ishte armata gjermane në gjendje të formojë Divizionin SS Skanderbeg në Kosovë, dhe jo në Shqipëri? Çfarë do t'i kishte ndaluar nga krijimi i tij në Kosovë? Cili ishte motivimi i shqiptarëve të Kosovës për t'ju bashkuar Divizionit SS?

MATERIALI E KOHA

Nuk nevojitet material

25 min a: 10 min b: 15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: IX dhe XII

2

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Reflektim mbi rëndësinë e zgjedhjes personale dhe guximit qytetar, duke shqyrtuar rreziqet që i bartin vendimet e marra nga ata që më pastaj janë njohur si Të Drejtë Mes Kombeve.

Porosia kryesore:

Në situata sfiduese, është më e vështirë dhe më e rrezikshme të angazhohesh për vlerat tua. Kjo nënkupton veprime të guximit të fortë qytetar. Vërtetë, personat e njohur si Të Drejtë Mes Kombeve rrezikuan jetën e vet për të shpëtuar hebrenjtë.

Për definicione, ju lusim referojë fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe të vogla ose në çifte. Në fund të pjesës c., secili grup i ndanë përgjigjet e veta me grupet tjera. Secilit grup i jepet një kopje e vjershës.

Lexo vjershën dhe diskuto pyetjet në vijim:

- Çfarë mendoni se është kuptimi i kësaj vjershe? Çfarë tregon për ata që ishin të ndjekur dhe për ata që nuk ishin?
- Krahaso situatën në vjershë me situatën me të cilën u përballën familjet shqiptare dhe kosovare

MATERIALI E KOHA

SHTOJCA 1: Vjersha e Niemöeller-it (një kopje për secilin grup)

30 min a: 15 min b: 15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a. IX dhe XII b. IX dhe XII

(mund të përdoret si alternativë më e thjeshtë për detyrën 3)

3

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Reflektim mbi rëndësinë e zgjedhjes personale dhe guximit qytetar, duke shqyrtuar rreziqet që i bartin vendimet e marra nga ata që më pastaj janë njohur si të Drejtë Mes Kombeve në mesin e popujve.

Porosia kryesore:

Në situata sfiduese, është më e vështirë dhe më e rrezikshme të angazhohesh për vlerat tua. Kjo nënkupton veprime të guximit të fortë qytetar. Vërtetë, personat e njohur si të Drejtë Mes Kombeve rrezikuan jetën e vet për të shpëtuar hebrenjtë.

Për definicione, ju lusim referojë fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë), për të hulumtuar dhe shqyrtuar tregimet e "Të Drejtëve Mes Kombeve". Në fund të punës grupore, diskuto pjesën c., në diskutim plenar.

Bazuar në tregimet e njerëzve të njohur si "Të Drejtë Mes Kombeve", diskuto pyetjet në vijim:

- Hulumto tregimin e ndonjë personi që i është dhënë titulli i "Të Drejtëve Mes Kombeve": Çfarë ka bërë ai/ajo? Çfarë kuptimi kishte kjo për të? Cilat arsye dhe vlera e shtynë atë drejt kësaj zgjedhje të rrezikshme?
- Paramendoje familjën tënde të marrë vendim të pranojë një hebre të panjohur për një vit. Cilat do të ishin sfidat dhe rreziqet e kësaj zgjedhje?
- A di për tjerë shembuj të guximit civil dhe rezistencës? Çfarë forma mund të marrë kjo? (p.sh., rezistenca jo e dhunshme kundrejt luftës së armatosur)

MATERIALI E KOHA

Lidhje në interes për hulumtim rreth Të Drejtëve Mes Kombeve (ose tregimet e zgjedhura të printuara nga mësimdhënësi)

30-35 min a: 10 min b: 10 min c: 10-15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: IX dhe XII c: XII

4

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Reflektim mbi rëndësinë e përkujtimit dhe mbamendjes për shoqëritë e sotme: të kuptuarit e rëndësisë së ndërlidhjes e kaluar, e tashme dhe e ardhme.

Porosia kryesore:

Të mbahet në mend historia është jashtëzakonisht e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë së sotme: njohja se çfarë ka ndodhë në të kaluarën dhe mësimi prej kësaj në lejon të ndërtojmë një të ardhme më të mirë. Me qëllim të evitimit të përsëritjes së gabimeve të njëjta, është me rëndësi të vërtetohen faktet dhe të dëgjohen tregimet e viktimave dhe të mbijetuarve nga të gjitha anët. Hapësirat përkujtuese luajnë një rol vendimtar, duke na lejuar të përkujtojmë ngjarjet historike dhe për të ngritur zërin për mos-përsëritje në të ardhmen ("kurrë më").

Për definicione, ju lusim referoju fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë). Në fund të pjesës c. (ose në fund të secilës pjesë), secili grup paraqet përgjigjet e veta në diskutim plenar.

Në këtë njësi mësimore, kemi përmendur rëndësinë e ruajtjes së kujtimit për të kaluarën. Duke menduar se si Holokausti përkujtohet (përmes përmendoreve, ngjarjeve, etj.), diskuto pyetjet si vijon:

- Si përkujtohet Holokausti në Kosovë?
- Si përkujtohet Holokausti në vendet tjera? Secili grup fokusohet në një prej shteteve: Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Gjermania, Italia
- A mendoni se është me rëndësi të përkujtohet Holokausti? Pse po? Ose pse jo? Nëse po, në çfarë mënyra mund të bëhet kjo?

MATERIALI E KOHA

Lidhje në internet për hulumtim

40 min

a: 10-15 min b: 10-15 min c: 15 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: IX dhe XII c: XII

5

REZULTATET E TË NXËNIT DHE POROSIA KRYESORE

Të kuptuarit e realitetit të sotëm për komunitetin hebre në Kosovë, dhe shkaktarët e situatës aktuale.

Porosia kryesore:

Sot, vetëm një numër i vogël i hebrenjve jetojnë në Kosovë, kryesisht në Prizren. Si rezultat i Holokaustit dhe regjimit pasues socialist, ka vetëm pak gjurmë të një komuniteti më të madh hebre që një herë kishte jetuar në Kosovë, dhe ruajtja e trashëgimisë hebreje ka qenë shumë e neglizhuar.

Ky është një shembull i pasojave afatgjate të ngjarjeve në të kaluarën, posaçërisht konflikteve, në shoqëritë e tashme.

Për definicione, ju lusim referojmë fjalorit

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe (3 deri 5 anëtarë), dhe hulumtojnë informata për komunitetin hebre në Kosovë sot. Në fund të punës grupore, diskuto gjetjet në diskutim plenar dhe krahasoi ato me fotografitë në Shtojcën 1 (mësimdhënësi mund t'ju tregojë ato nxënësve).

Duke pasë në mendje Kosovën sot, diskuto pyetjet në vijim:

- Çfarë di ti për jetën hebreje në Kosovë sot?
- A di për ndonjë zonë hebreje në Kosovë?

[Kjo detyrë mund të ndërlihet me një vizitë studimore në hapësirat (ose familjet) relevante hebreje në Prishtinë ose Prizren]

MATERIALI E KOHA

Lidhje në internet për hulumtim

SHTOJCË 2: si referencë për t'ju treguar nxënësve.

20 min a: 10 min b: 10 min

VËSHTIRËSIA/KLASA

a: IX dhe XII b: IX dhe XII

SHTOJCË 1:

Një herë erdhën t'i marrin hebrenjtë
Dhe unë nuk ngrita zërin,
Sepse nuk isha hebre.

Pastaj erdhën t'i marrin komunistët
Dhe unë nuk ngrita zërin,
Sepse nuk isha komunist.

Pastaj erdhën t'i marrin sindikalistët
Dhe unë nuk ngrita zërin,
Sepse nuk isha sindikalist.

Pastaj erdhën të më marrin mua,
Dhe nuk kishte mbetur askush,
Që të ngrisë zërin për mua.

nga Martin Niemöller

SHTOJCË 2:

Hapësirat përkujtuese hebreje në Prishtinë



Përmendore që shënon vendin ku qëndronte sinagoga e vetme në Kosovë, deri në vitin 1963. Shënimi gjithashtu nderon hebrenjtë kosovarë të vrarë gjatë Holokaustit

Burimi: Autorët/forumZFD



Varrezat hebreje në Velani

Burimi: https://en.wikipedia.org/wiki/Historical_monuments_in_Pristina#Jewish_cemetery



Klubi i boksit Prishtina, një ndërtesë e braktisur që besohet të ketë qenë një shkollë hebreje

Burimi: <https://www.timesofisrael.com/in-muslim-kosovo-a-jewish-claim-to-nations-past-and-future/>



Varrezat hebreje në Arbëri/Dragodan

Burimi: <https://jewish-heritage-europe.eu/2019/12/17/kosovo-jewish-cemetery-in-pristina/>

FJALOR

Kujdes! Disa nga fjalët në këtë fjalor shpjegojnë shprehjet e përdorura nga nazistët. Këto shprehje u sajuan nga nazistët si fjalë propagandistike, eufemiste, për të fshehur ideologjinë raciste pas tyre. Ato fjalë janë shënuar me shprehjen “*Eufemizëm nazist!*”.

ANTI-JUDAIZËM: kundërshtimi i plotë ose i pjesërishtë i judaizmit si religjion, duke shtyrë në ndjenja dhe sjellje armiqësore të motivuara nga religjioni, kundër hebrenjëve.

ANTISEMITIZËM: ndjenjat negative, paragjykimet dhe sjelljet armiqësore kundër hebrenjëve si grup etnik ose “racë”. Antisemitizmi është një formë e racizmit që i definon hebrenjtë si grup etnik ose racë e cila mund të identifikohet me karakteristika fizike ose sjellje të caktuara, duke neglizhuar faktin se hebrenjtë janë një grup i shumëllojshëm i njerëzve. Në gjuhën moderne, shprehja “antisemitizëm” mbulon totalin e deklaratave, prirjeve, fyerjeve, qëndrimeve dhe veprimeve (përfshirë diskriminimin dhe dhunën), pa marrë parasysh se a janë ato me motivim religjioz, racor, shoqëror ose tjetër.

ARIANËT: një shprehje që emërton popujt indo-iranian të cilët pjesërisht emigruan në Evropë në mes të viteve 2700 dhe 700 para erës së re dhe ndikuan gjuhët dhe teknologjinë e popujve aty. ideologjia naziste, raciste e përdori këtë shprehje për të përshkruar bashkimin e popujve të Evropës Veriore dhe atyre gjermanë si një racë që është më superiore ndaj të gjitha racave tjera (Eufemizëm nazist!).

ASHKENAZI: Diaspora hebreje që jetonte kryesisht në Evropën Qëndrore dhe Lindore në mijëvjeçarin e parë të erës së re. Disa prej tyre u shpërngulën edhe në Ballkan. Gjuha e tyre tradicionale është jidish, dhe ata gjithashtu kanë zhvilluar ceremoni të veçanta fetare. Sot, shumica e hebrenjëve në mbarë botën identifikojnë veten ose paraardhësit e tyre si ashkenazi.

ASIMILIM: asimilimi kulturor është proces socio-kulturor në të cilin një grup ose kulturë pakicë fillon të përngjajë në grupin shumicë, duke u identifikuar me të dhe duke përvetësuar sjelljet dhe besimet e tij. Si pasojë, individit ose grupit i “shkrirë” mundet që pjesërisht ose plotësisht të humbë identitetin e vet kombëtar/kulturor ashtu që nuk mund të dallohet nga grupi (më i madh). Asimilimi mund të jetë vullnetar ose i imponuar.

AUSCHWITZ (AUSHVIC) është emërtimi gjerman për qytetin Oświęcim në Poloni. Nazistët ndërtuan kampin më të madh të përqendrimit në periferi të këtij qyteti. Pjesa e parë e kampit quhej Auschwitz I; Auschwitz II - Birkenau ishte pjesa më e madhe e kampit dhe përfshinte dhomat e gasit që shërbenin për shfarosjen e hebrenjëve (për ç’arsye Auschwitz gjithashtu quhet edhe kampi i shfarosjes.); dhe Auschwitz III - Monowitz ishte një kamp i punës së detyrueshme. Vlerësohet se rreth 960.000 hebrenj, 74.000 polakë jo-hebrenj, 21.000 romë, 15.000 të burgosur sovjetikë të luftës dhe 10.000-15.000 të tjerë vdiqën aty.

COUP D’ETAT (grusht-shteti): rrëzim ilegal, zakonisht i dhunshëm i ndonjë qeverie ekzistuese ose ndonjë udhëheqësi, nga një grup i vogël (nga frëngjishtja, dhe fjalë-për-fjalë nënkupton “goditje e shtetit”).

DIASPORA: shpërndarja e njerëzve nga atdheu i tyre. Gjithashtu tregon komunitetin që jeton jashtë atdheut të tyre, në shtet ose vendndodhje tjetër. Shprehja vjen nga fjala greke “diaspora” dhe ka kuptimin “shpërndarje, përhapje”.

DISKRIMINIM: veprimi i trajtimit të një individi ose grupi të caktuar ndryshe – posaçërisht më keq se të tjerët – për shkak të identitetit të tyre (etnik, gjinor, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, karakteristikave fizike, etj.), zgjedhjeve të tyre (mendimet politike, religjioni, orientimi seksual, etj.) ose situatës së tyre (të meta, situata familjare, aftësitë, etj.). Kjo më së shumti ndodh ndaj njerëzve që i konsiderojmë si “ndryshe” prej nesh, për arsye të çfarëdoshme. Diskriminimi është prezent në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në sjelljen e personit/grupit që diskriminon si edhe te ata që janë fokus i diskriminimit. Veprimet diskriminuese i bëjnë njerëzit e synuar të ndjejnë frikë dhe frustrim, humbje të vazhdueshme të vetëbesimit, pasiguri dhe dhunë potenciale.

DITA NDËRKOMBËTARE E PËRKUJTIMIT TË HOLOKAUSTIT: ditë ndërkombëtare përkujtuese që shënon Holokaustin, me 27 janar. Kjo ditë u caktua më 2005, me një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Data u zgjodh sepse me 27 janar 1945 Armata e Kuqe Sovjetike arriti në Auschwitz.

DIVERSITET KULTUROR: bashkëjetesa e një llojllojshmërie të grupeve kulturore, etnike, fetare ose gjuhësore përbrenda një shoqërie.

DHUNË: veprimet, fjalët, qëndrimet strukturat ose sistemet të cilat shkaktojnë dëm fizik, psikologjik, shoqëror ose ambiental, dhe pengojnë njerëzit në arritjen e potencialit të tyre të plotë. Dhuna direkte fizike (p.sh., goditjet, rrahja, të shtënat, dhunimi, tortura) është forma më e dukshme e dhunës, por nuk është e vetmja. Dhuna mund të jetë edhe psikologjike dhe verbale, kulturore (p.sh., traditat dhe besimet të cilat justifikojnë përdorimin e dhunës, seksizmi, vlerat patriarkale, diskriminimi), ose strukturore (p.sh., varfëria, korruptimi, pabarazitë shoqërore, çasja jo e barabartë në të drejta dhe resurse).

EINSATZGRUPPEN: drejtpërdrejtë nënkupton “grupet operative” (Eufemizëm nacist!) ishin njësi të Schutzstaffel (SS) të cilat avanconin në territoret e pushtuara rishtazi me detyrë të mbledhjes së informatave për identitetin dhe vendndodhjen e popullatës lokale hebreje dhe për t’i masakruar. Ata gjithashtu vranë elitën intelektuale të Polonisë, të burgosurit sovjetikë të luftës, romët, luftëtarët rezistues ndaj pushtimit gjerman dhe të tjerë. Vlerësohet se Einsatzgruppen ka vrarë më shumë se 2 milion njerëz, 1.3 milion prej tyre hebrenj.

EMANCIPIMI: procesi i arritjes së të drejtave të barabarta ekonomike, shoqërore dhe politike për një grup të caktuar që ka qenë i diskriminuar deri atëherë. Në kontekst të historisë së hebrenjve, kjo shprehje përshkruan procesin historik të zbutjes së politikave dhe ligjeve diskriminuese ndaj tyre.

GETO: një pjesë e një qyteti në të cilën jetojnë njerëz të varfër ose që i takojnë një grupi të caktuar, të ndarë nga pjesa tjetër e popullatës. Getot u përdorën nga nazistët për të ndarë hebrenjtë nga pjesa tjetër e shoqërisë, duke ju mohuar trajtim të barabartë dhe të drejtat e tyre.

GUXIM QYTETAR: kur një individ ose grup vepron lidhur me ndonjë çështje të rëndësishme për komunitetin, duke rrezikuar me të madhe veten dhe pa ndonjë përfitim të drejtpërdrejtë. Këta individë jo domosdo i bindin të tjerët për kohë të shkurtë, mirëpo veprimet e tyre guximtare e udhëzojnë shoqërinë drejt vlerave më të mira dhe drejt barazisë më të madhe.

GJENOCID: aktet e kryera me qëllim të shkatërrimit, të plotë ose të pjesshëm, të një grupi kombëtar, etnik ose fetar (siç është përcaktuar në Konventën e KB për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, Neni 2).

HANDSCHAR: rrjedh nga shprehja “Hanxhar”, që i referohet thikës luftarake osmane. Divizioni Handschar ishte divizioni i këmbësores së SS. U formua në 6 dhjetor 1942 për të luftuar partizanët në “Shtetin e Pavarur të Kroacisë” (që përfshinte Kroacinë e sotme si edhe pjesë të Bosnjës dhe Hercegovinës), por gjithashtu ushtroi mizori kundër civilëve hebre dhe serbë. Myftiu i Jerusalemit ndihmoi në rekrutimin e myslimanëve boshnjakë për njësinë, deri sa një numër i vogël ishin kroatë katolikë të rekrutuar. Përkundër shkallës së lartë të dezertimit, njësia luftoi Armatën e Kuqe dhe atë të Bullgarisë, të cilat po avanconin, deri në humbjen e Gjermanisë.

HOLOKAUST: shprehja “holokaust” vjen nga dy fjalë greke, që nënkuptojnë “fljimi me zjarr, për Zotin”. Shprehja më vonë u përdor për të përshkruar shfarosjet totale dhe sistematike të kryera nga Gjermania naziste dhe bashkëpunëtorët e saj, me qëllim të asgjësimit të hebrenjve.

ILUMINIZMI: shprehje që ka kuptime të ndryshme; në kontekste historike i referohet Epokës së iluminizmit që ndodhi në shumë shoqëri evropiane midis shekujve XVII dhe XVIII. Ajo u manifestua si një lëvizje intelektuale dhe filozofike që rizbuloi mendimet filozofike antike greke dhe i dha vëmendje të veçantë racionalitetit dhe arsytimit. Si e tillë, ajo përkrahte ndarjen e kishës dhe shtetit dhe bazimin e njohurive mbi shkencën, jo besimin. Intelektualët hebrenj i morën ato koncepte dhe interpretuan kuptimin e tyre për komunitetet hebreje. Si rezultat, një identitet i veçantë hebre, përdorimi i hebraishtes (në vend të Jidish) dhe integrimi i hebrenjve në shoqëritë përreth tyre (përfshirë përvetësimin e gjuhëve dhe zakoneve të tyre) u mbështetën. Iluminizmi Hebre quhet ndryshe “Haskalah”.

INTEGRIMI: veprimi i përfshirjes së dikujt si pjesë e grupit ose shoqërisë, duke i garantuar të drejtat dhe mundësitë. Një qëndrim integruës përfshinë vullnetin e personave/grupeve të përfshira për të bashkëpunuar mes vete me qëllim të përmirësimit të kushteve për të gjithë.

KAMP: gjatë nazizmit, kampet e përqendrimit (të quajtura gjithashtu edhe “kampet e arrestimit”, “kampet e mbajtjes” ose “kampet e punës” – eufemizëm nacist!) u themeluan si hapësira ku një numër i madh i njerëzve (mbi të gjitha hebrenjtë por edhe grupe tjera të përndjekura si romët, kundërshtarët politikë, të burgosurit e luftës, homoseksualët, hendikapët, polakët dhe të tjerë që konsideroheshin se janë sllavë, Dëshmitarët e Jehovait e të tjerë) u mbyllën dhe shpesh përdorreshin për punë të detyrueshme. Kampet e shfarosjes i shërbyen planit nazist për shfarosje sistematike të hebrenjve dhe grupeve tjera. Shumë hapësira për shfaroje ju shtuan kampeve të përqendrimit pas aprovimit të politikës së “Zgjidhjes Finale”, në 1942.

LEBENSRAUM: shprehje gjermane, që përkthehet si “hapësirë jetese”, që përmbante parimin e ideologjisë nacistë që populli gjerman do të ketë nevojë dhe e meriton një hapësirë më të madhe jetese se sa që kishin në dispozicion në Rajhun Gjerman (Eufemizëm gjerman!). Si pasojë, ajo justifikonte pushtimin, okupimin dhe aneksimin e pjesëve të mëdha të Evropës Qendrore si edhe dëbimin, diskriminimin, skllavërimin, uritjen dhe vrasjen masive të njerëzve në ato rajone (shumica e të cilëve konsideroheshin sllavë, dhe si të tillë inferiorë në krahasim me gjermanët).

OKUPIM: fuqia ushtarake dhe/ose politike mbi një territor, pa shpallur sovranitet formal mbi të (p.sh. aneksimi për t’ia shtuar një hapësirë shtetit të vet). Nazistët zgjeruan territorin sovran të Gjermanisë, por jo në të gjitha hapësirat mbi të cilat gjermanët patën pushtet. Për shembull, Jugosllavia nuk ishte kurrë pjesë e Rajhut, por u nda në shtete kukulla që ishin nën sundimin gjerman, derisa Shqipëria ishte shtet kukull, fillimisht nën sundimin italian, e më pas nën atë gjerman.

PARAGJYKIM: një përgjithësim që përmban një vlerësim/mendim zakonisht negativ lidhur me njerëzit ose grupet tjera shoqërore, bazuar në paraqitjen e tyre, ngjyrën e lëkurës, gjininë, origjinën dhe cilësitë tjera. Paragjykimi nënkupton “gjykim paraprak”; pra formohet para kohe, pa njohuri apo përvojë të drejtpërdrejtë. Nganjëherë, paragjykimet arsyetohen duke iu referuar përvojave të mëhershme, megjithatë, përvojat personale kurrë nuk mund të paraqesin të gjithë grupin.

POGROM: kryengritje e dhunshme popullore me qëllim të vrasjes apo ndjekjes së një grupi etnik ose religjios. Përdorimi i shprehjes “pogrom” fillimisht i referoheshin sulmeve ndaj hebrenjve në Perandorinë Ruse gjatë shekujve XIX dhe XX.

PROPAGANDA: informatat, idetë, mendimet ose imazhet që transmetohen, publikohen, ose shpërndahen në mënyra tjera, me qëllim të ndikimit të mendimeve të njerëzve. Ata që prodhojnë propagandë (individët dhe grupet, siç janë partitë politike) qëllimisht angazhohen të shkaktojnë një përgjigje ose reagim, i cili favorizon synimet e tyre.

RAJHU I TRETË: emërtimi zyrtar nazist për regjimin në Gjermani nga janari 1933 deri në maj 1945, që e konsideronte veten pasardhës të Perandorisë së Shejtë Romake (Rajhu i Parë) dhe të Perandorisë Gjermane (Rajhu i Dytë). “Rajhu i Tretë” është një shprehje propagandistike (Eufemizëm nacist!) prandaj nuk paraqet shprehje të saktë historike.

“SCAPEGOAT”: fjalë e përafërt në shqip është “kurban”, ku me scapegoating emërtohet akti kur një person ose grup fajëson një person ose grup tjetër për ndonjë problem, pa të drejtë. Si rrjedhojë, personi ose grupi i fajësuar, që shihet si “kurban”, vuan trajtim të keq. “Scapegoating” përdoret për të shpjeguar në mënyrë të gabuar përse ndodh ndonjë problem i caktuar shoqëror, ekonomik ose politik. Shprehja “scapegoat” i referohet tregimit të Levitikut (në Torah/Tevrat dhe Bibël), ku kjo praktikë është dukshëm e dokumentuar.

SCHUTZSTAFFEL (shkurtesa: SS): fjalë-për-fjalë përkthehet si “forcat mbrojtëse” (Eufemizëm nacist!). SS u formuan si njësi elitare para-ushtarake e partisë naziste që shërbente si trupojë e Hitlerit dhe si forcë speciale policore. Më pas, disa prej njësive të SS u përdorën si njësi të rregullta ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të tjerat si roja dhe xhelatë në kampe. Si pasojë, SS ishte organizata më përgjegjëse për vrasjen e hebrenjve.

SEFARDI: Popullata e diasporës hebreje që jetonte kryesisht në Spanjë dhe Portugali deri në fund të shekullit të XV, kur u ndoqën nga aty dhe u shpërndanë përgjatë Perandorisë Osmane. Në këtë mënyrë shumë prej tyre u shpërngulën në të gjitha pjesët e Mesdheut dhe të Perandorisë Osmane, përfshirë Ballkanin. Gjuha e tyre tradicionale është ladino, dhe ata zhvilluan rite të posaçme fetare. Sot, deri në 15-20% të hebrenjve në mbarë botën identifikojnë veten ose pasardhësit e tyre si sefardi.

SINAGOGA: është shtëpi hebreje e adhurimit, si xhamia për myslimanët ose kisha për të krishterët. Shprehja vjen nga Greqia antike; në gjuhën hebreje shtëpitë hebreje të adhurimit quhen “bet kneset” (fjalë-për-fjalë: “shtëpia e mbledhjes”).

STEREOTIPI: një imazh ose ide për një grup ose person të caktuar e bazuar në gjeneralizim të tej-thjeshtëzuar të një karakteristike të atij grupi ose atij lloji të personit. Si rezultat, anëtarët e këtij grupi ose të gjithë njerëzit me atë karakteristike shihen me atë imazh ose ide, duke shpërfillë karakteristikat individuale. Stereotipat mund të jenë edhe negative edhe pozitive, por ato janë gjithmonë të gabuara; edhe nëse një imazh ose ide për një grup është i saktë për shumicën, ato nuk do të jenë kurrë të sakta për të gjithë anëtarët e atij grupi. Për më shumë, trajtimi i një personi sipas stereotipit është i gabueshëm, sepse nuk i merr parasysh karakteristikat individuale.

SHTET KUKULL: një shtet me qeveri, ligje, flamur etj. të vetat, e që është plotësisht i varur nga një shtet tjetër, prandaj jo edhe i pavarur. Kjo nënkupton që shteti është plotësisht sovran, por i kontrolluar nga një shtet tjetër. Shembuj të shteteve

kukull në sundimin gjerman ose italian gjatë Luftës së Dytë Botërore janë: Shqipëria, Shteti i Pavarur i Kroacisë (Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina). Shteti Helen i Greqisë (Greqia) dhe Qeveria e Shpëtimit Kombëtar (Serbi). Bullgaria, nga ana tjetër, ishte shtet i pavarur, por me qeveri fashiste e cila vendosi të bëhet anëtare e fuqive të Boshtit.

TË DREJTIT MES KOMBEVE: është titull që jepet nga Yad Vashem (Qendra Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit në Jerusalem, Izrael) për jo-hebrenjtë të cilët rrezikuan shumë për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Holokaustit.

TOLERIM: shprehja e pranimi të ekzistimit ose prezencës së dikujt ose diçkaje në shoqëri me pajtim të heshtur ose të hapur të shumicës së asaj shoqërie. Tolerimi nënkupton bashkëjetesën, por jo edhe marrëdhënie bashkëpunuese në mes të palëve, e as të drejta të barabarta. Kjo do të thotë se ka tolerancë të secilës palë ndaj tjetrës, por nuk ka respekt, dhe ndërveprimi paraqitet vetëm nëse është i domosdoshëm ose i kërkuar nga rrethana të caktuara.

USTASHËT: vjen nga folja kroate “ustati” (“ngritja”) dhe i referohet lëvizjes “Ustaša – Hrvatski revolucionarni pokret” (“Ustashët – Lëvizja Kroate Revolucionare”), që ishte një lëvizje fashiste kroate, organizatë terroriste ultranacionaliste, e cila ekzistoi prej 1929 deri në 1945. Ideologjia e saj mbështetet zgjerimisht në ideologjinë raciste të nazistëve. Ata pohonin se kroatët dhe boshnjakët ishin pjesë e racës gjermanike dhe i konsideronin hebrenjt, romët dhe sllavët (posaçërisht serbët) si më të ulët. Në Shtetin e Pavarur të Kroacisë, ustashët ishin milici e cila vepronte ndaras nga ushtria e rregullt dhe vrau qindra mijëra serbë, hebrenj, romë si edhe kundërshtarë politikë.

XHANDARMËRIA: shprehje e moçme “polici” ose “polici ushtarake”. Në Shqipëri, Xhandarmëria Mbretërore Shqiptare (Arma e Xhandarmërisë) u formua pas pavarësimit të vendit nga Perandoria Osmane. Gjatë pushtimit të Shqipërisë në 1939, shumë xhandarë ishin në anën e rezistencës dhe luftuan kundër italianëve.

ZGJIDHJA FINALE: formë e shkurtër e shprehjes “Zgjidhja Finale e Çështjes Hebreje”, si përkthim nga shprehja gjermane “Endlösung der Judenfrage”, e cila pretendon se ka një çështje të hapur ose problem të pazgjedhur lidhur me ekzistimin e hebrenjve, që kërkon zgjidhje ose vendim final (Eufemizëm nacist!). Fillimisht, liderët nazistë shqyrtonin deportimin e të gjithë hebrenjve, për të kaluar më pas në shfarosjen e tyre. Ky ndryshim ndodhi gradualisht dhe vrasjet masive ndodhën qysh më 1941, por në përgjithësi Konferenca Wansee në janar 1942 konsiderohet si ngjarja kur “Zgjidhja Finale” u formulua proceduralisht dhe gjeografikisht si politikë për shfarosjen e të gjithë hebrenjve në Evropë.

Partnerët në projekt:

Shoqata e Mësimdhënësve të Historisë së Kosovës (SHMHK): u themelua në vitin 2008 me qëllimin kryesor të promovimit të mësimdhënies cilësore të historisë përbrenda sistemit arsimor të Kosovës dhe të lehtësojë shkëmbimin e përvojave të mira në mes të mësimdhënësve. Shoqata është anëtare e rrjetit EUROCLIO.

New Perspektiva: OJQ New Perspektiva punon që të kontribuojë në të kuptuarit e dialogut të lehtësuar nga BE dhe të procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, si edhe të nxisë integrim më të madh në mes të komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Ajo ka udhëhequr projekte në hapjen e të menduarit për metodologjinë e shumë-perspektivës (multiperspektivës) në të mësuarit dhe mësimin për historinë në Kosovë.

ForumZFD: (Forum Ziviler Friedensdienst – Shërbimi Civil Paqësor) është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse Gjermane, themeluar në 1996. Në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor, forumZFD është aktiv në fushën e Ballafaqimit me të Kaluarën dhe Arsimimin për Paqe. Përmes projekteve të ndryshme, forumZFD bashkëpunon me organizata lokale dhe me hisedarët tjerë për të ndërtuar një kulturë të paqes, për të promovuar ballafaqim konstruktiv me të kaluarën dhe për të lehtësuar proceset e pajtimit.

Yad Vashem: themeluar në 1953 me dekret të Knesset-it (Parlamenti i Izraelit). Yad Vashem, Qendrës Botërore të Përkujtimit të Holokaustit, i është besuar detyra e përkujtimit, dokumentimit, hulumtimit dhe arsimimit lidhur me Holokaustin. Qasja e integruar e Yad Vashem përfshinë nisma arsimore, hulumtime novatore dhe ekspozita frymëzuese.

Qendra për Hulumtim të Historisë, e Akademisë Polake të Shkencave në Berlin: themeluar në 2006, është një nga gjashtë institucionet e Akademisë Polake të Shkencave, dhe i pari me profil të historisë dhe me projekte vetanake hulumtuese. Qëllimi kryesor i qendrës është të hulumtojë historinë e marrëdhënieve gjermano-polake, në kontekst të historisë evropiane.

Haus der Wannseekonferenz: në Berlin, sot është një Qendër Përkujtimore dhe Arsimore që ofron një diapazon të gjerë të ekspozitave dhe programeve edukative për mësimin e historisë së Holokaustit, historisë së nacional - socializmit, parahistorinë dhe pasojat e tij. Në hapësirën e njëjtë ku gjendet kjo qendër, më 20 janar 1942, pesëmbëdhjetë përfaqësues nazistë të nivelit të lartë planifikuan të ashtuquajturën “Zgjidhje Finale”.

Muzeu i Përkujtimit të Holokaustit i Shteteve të Bashkuara: në Uashington D.C., është hapësira kryesore përkujtimore dhe muze dedikuar Holokaustit, në Shtetet e Bashkuara. Misioni i tij është të japë mësim për Holokaustin me qëllim të promovimit të luftës për dinjitet njerëzor si edhe kundër urrejtjes dhe shkeljeve të mëdha të të drejtave të njeriut.

